

Distancohen institucionet, Bojaxhi nuk mërzhitet për reagimet

Fq.5




STANDARDET
Të fundit në Evropë me mësimin e përjetshëm

Fq.6



Shkolla!
Adelina Marku
FORUM

Fq.10



Koha

www.koha.mk



Korrigjimi i Ballkanit

Fq.4

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3451 · e martë, 4 shtator 2018

16°C | 28°C

15 DEN

EDITORIAL

Një film antishqiptar që do të duhej ndaluar!



Në një film ku shqiptarët paraqiten kidnapues në luftën e 2001-shit, si bashkëprodhues paraqitet edhe një kompani nga Shqipëria. Filmi "Tallje me Krish-tin", është financuar nga Agjensia e Filmit e Maqedonisë dhe përveç Shqipërisë në këtë...

Fq.2

RAJON

Barrikadimi kundër Thaçit

Fq.14

HISTORI

Zonja që çalonte, spiunia e frikshme amerikane

Fq.17

GLOBI

Llogaritë gabim të Macronit

Fq.15



FILLON FUSHATA INTENSIVE, MERKELI TË SHTUNËN NË SHKUP

VMRO E VETME KUNDËR TË GJITHËVE!



VMRO opozitare pritet të vazhdojë me protesta kundër Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Kjo parti nuk do të bojkotojë Referendumin ndërkaq e gjitha garnitura partiake dhe anëtarët e saj, siç flitet kuluareve partiake, do të lihen të lirë të marrin pjesë apo jo në referendum, ashtu sikurse do të jenë të lirë ditën e votimit, por me gjasë vota pritet të jetë kundër në kutitë e votimit për ata që do të dalin

Fq.3

Nëse nuk na ndihmoni, të paktën mos na pengoni

Kaçanik, 3 shtator - Oda Ekonomike e Maqedonisë (OEM) dhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK, janë ndër odat më të radha në rajon që kanë traditë të mirë bashkëpunimi më të gjatë se sa vetë shtetet dhe pikërisht kjo na bënë të jemi lider nga vendet e rajonit. Dhe në të ardhmen, do të punojmë më shumë në avancimin e aktiviteteve si në fushat ekonomike, por edhe ato politike. Kështu deklaruan Berat Rukiqi,

kryetari i OEK-së dhe Branko Azeski, kryetari i OEM-së në konferencën e përbashkët në vendin ku mbaron segmenti i përfunduar i autostradës Prishtinë-Shkup, gjegjësisht në fshatin Doganaj të Kaçanikut. Duke folur për procesin e integritimeve të Kosovës dhe Maqedonisë në Bashkimin Evropian (BE) dhe mundësitë e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, Branko Azeski u shpreh se...

Fq.7



EDITORIAL

NJË FILM

ANTISHQIPTAR QË DO TË DUHEJ NDALUAR!



Emin AZEMI

Në një film ku shqiptarët paraqiten kidnapues në luftën e 2001-shtit, si bashkëprodhues paraqitet edhe një kompani nga Shqipëria. Filmi „Tallje me Krishtin”, është financuar nga Agjencia e Filmit e Maqedonisë dhe përveç Shqipërisë në këtë llojë kinematografike kanë marrë pjesë edhe producentë nga Greqia e Sllovenia, kurse premiera botërore ishte në Festivalin e filmit në Montreal, nga 23 gushti deri më 3 shtator. Sipas fjalëve të regjisorit Jani Bojaxhi, ky film do të prezantohet edhe në katër festivale në Europë, ndërkohë që premiera në Maqedoni do të jetë në film të tetorit.

Në Maqedoni, ndodhin shumë paradokse, kurse vet profilet e kundërta të regjisorit Bojaxhi dhe drejtorit të Agjencisë së Filmit, Gorjan Tozija, janë paradokse më vete. Përderisa Bojaxhi është një nga 76 nënshkruesit e peticionit të intelektualëve maqedonas kundër Marrëveshjes së Pespës, në anën tjetër, Tozija ishte pjesëmarrës aktiv i të ashtuquajturit “Revolucioni i larmë” për rrëzimin e pushtetit pararendës.

Se si kanë mundur të bashkëpunojnë këto dy profile kundërshtuese njerëzish brenda një projekti, këtë mund ta shpjegojë ndoshta e përbashkëta e filmit, që është përmbajtja antishqiptare.

Ndonëse Ministria e Kulturës u mundua të thotë se “Agjencia e Filmit është institucion i pavarur nga Ministria e Kulturës”, kjo nuk mjafton që të jepet një përgjigje edhe më adekuate kundrejt këtij projekti kontrovers, duke mos e lejuar në të ardhmen të shfaqet në kinematë e Maqedonisë. Ministria e Kulturës nuk shtë OJQ për të dhënë vlerësime se „lojëra të tilla tendencioze me historinë, ngjarje që dëmtojnë bashkëjetesën e qytetarëve - financues të veprave të tilla, më nuk do të gjejnë mbështetje”.

Filmi „Tallje me Krishtin” nuk duhet lejuar që të shfaqet në publik, kurse Ministria e Kulturës, si institucion kompetent, duhet kërkuar llogaridhënie nga të gjithë ato segmente shtetërore që e mbështetën politikisht dhe financiarisht këtë projekt kontrovers.

Realiteti faktik në vitin 2001 nuk përkon me realitetin fiktiv të filmit „Tallje me Krishtin”. Usharët e UÇK-së atëbotë ishin shumë të disiplinuar, kurse komandantët e tyre iu përmbaheshin doktrina-ve humane, duke kursyer civilët joshqiptarë nga çfarëdo lloj maltretimi i keqtrajtimi. Kjo ishte konfirmuar edhe në punën tonë në terren si gazetar, kur raportohej edhe për raste të veçanta kur guerilët e UÇK-së ndihmonin pleqtë maqedonas, të mbetur nëpër shtëpitë e fshatrave të Pollogut, që t'i kryejnë obligimet e tyre të përditshme.

Falsifikimi i historisë bëhet për shumë arsye, por ata që falsifikojnë zakonisht kanë kompleks inferioriteti ndaj vlerave të të tjerëve dhe projektet e tyre s'janë asgjë tjetër përpos shërim i komplekseve dhe kompensim i mungesës së talentit krijues.

Nevoja e regjisorit Jane Bojaxhi për të projektuar një realitet të falsifikuar nga koha jo e largët në shiritin e ceolulodit, nuk është vetëm një përpjekje e mjerë për të mbindërtuar një realitet të shpifur, por edhe një korrupsion i hapur etik që me paratë publike të ofendohet dhe etiketohet një kryengritje e pastër për prijje gjoja terroriste.

Ministria e Kulturës në asnjë mënyrë nuk ka guxuar të bie në nivelin e këtij tundimi pseudoartistik, kurse mbetet e paqartë se si i ka kaluar filtrat ky projekt kontrovers nga përfaqësuesit shqiptarë në këtë Ministri dhe në Qeveri?!

SHQIPTARËT DHE TEKNOLOGJIA

“Pa integrimin e teknologjive të reja të informacion - komunikimit shkolla shqiptare nuk do të jetë as në nivelin e kurseve kundër analfabetizimit!

- Pse shkolla shqiptare po i mbyll dyert telefonisë mobile?

- Si do ngjajnë si majmuna shqiptarët krahasuar me evropianët pas njëzet vjetësh nëse nuk bëjmë reformën e thellë dhe të vërtetë të shkollës?

- Pa teknologjinë e komunikimit, pse truri mbetet prapa?

- Kush e pengon informatizimin e shkollës shqiptare duke e lënë në nivelin oral dhe në platforma letre?

- Pse nuk dinë shkollaret të komunikojnë ?

- Pse përdoren telefonat mobilë si furnella me vajguri që ndotin mjedisin?

- Pse shkolla shqiptare i ngjan në këtë pikë inkuizicionit që luftonte progresin e dijeve?

- Pse duhet të kemi turp nga kujtimi i shkollës të motrave Qirjazi?”, shkruan në profilin e tij në Facebook, filozofi nga Tirana, Artan Fuga.

FILMI I RI I QEVERIS SONË

“Popull me kuzhinë politike dhe popull vetëm me parti politike. Populli me kuzhinë politike është ai, i cili hapin e hedh në momentet të caktuara përball konkurrentit të vet. Ai, gjithashtu në periudhat historike mban një pjesë të popullit rezervë për mendim alternativ që të i ndihmoj pasardhësve të vet në të ardhmen e largët. Ky popull gjithmonë krijon arsye për veprimet që i bën.

Populli që ka vetëm parti politike, shpeshherë e humb rrugën në oborr. Bën politik reaktive. Në momente të caktuara, ata që janë në pushtet e shpallin tradhtar gjithsecilin që nuk mendon si vet. Hapit politik nuk munden të ja qëllonjë kohën. Ky popull për arsyetim të veprimit gjithmonë i merr dëshirat e të huajve. Kemi film të ri na 'Qeveria jonë tani!', shkruan në FB, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.

INSTITUCIONALISTI

“Fjala ‘INSTITUCIONALIST’ duket se ekziston vetëm në gjuhën shqipe që flitet e shkruhet në Kosovë. Nëse këtë fjalë e kërkon në anglisht, e merrni këtë përgjigje:

‘Institutionalist - Word not found in the Dictionary and Encyclopaedia’

(Institutionalist - kjo fjalë nuk gjendet në Fjalor e as në Enciklopedi).

Megjithatë, kjo fjalë gjendet vetëm në fjalorin e shprehjeve ekonomike të gjuhës spanjole:

‘Institutionalistas: emër me të cilin janë quajtur një grup i ekonomistëve gjatë fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, të cilët nuk pajtoheshin me teorinë ekonomike bashkëkohore.’

Kjo fjalë në Kosovë mëton ta ketë një domethenie tjetër: Institutionalist: anëtar i LDK që i do institucionet shtetërore (kurse anëtarët e partive tjera, jo). Ç'ka s'ninë njeri. Turli fjale”, shkruan në profilin e tij në FB, publicisti nga Londra, Daut Dauti.

MEDIACitate

ARMIKU MË I MADH I EVROPËS NUK JANË MUSLIMANËT, POR POLITIKAT RACISTE QË ZBATON

Shefja e UNESCO-s për Leadership Evropian në Diplomaci Kulturore, Shkencore dhe Inovative pranë Institutit të Studimeve Evropiane në Bruksel, Dr. Naciye Selin Şenocak, ka theksuar se të rinjtë muslimanë të cilët janë të tjetërsuar dhe janë shpërbërë nga identiteti në Evropë, anëtarësohen te grupet terroriste me ndjenjën për të provuar ekzistencën e tyre dhe për të fituar një identitet dhe pushtet të ri. Naciye Selin Şenocak, duke folur për Anadolu Agency (AA), për rritjen e lëvizjeve të djathta ekstreme në Evropë, ndërhyrjet kundrejt Islamit dhe muslimanëve, ndërhyrjet e fundit të Francës për të ndryshuar disa nga ajetet e Kur'anit si dhe ndërhyrjet që kërkohen të bëhen ndaj islamofobisë dhe fesë islame, tha se “Armiku më i madh i Evropës nuk janë të rinjtë muslimanë, por politikrat racistë ndarëse që zbaton”. Në lidhje me çështjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fetare që Evropa kritikon Turqinë, Şenocak tha se për këtë Evropa duhet të marrë shembull nga Turqia, dhe ka shtuar se “si shembull konkret të kësaj mund të japim propozimin e ndalesës për mbulesën me shami të bërë nga ministrja e shtetit Zühal Demir javën e kaluar në Belgjikë”.

“Organizata terroriste për të cilën është simpatizante ministrja që ka paraqitur propozimin në fjalë, merr në male vajzat duke i kërcënuar dhe privuar ato nga liria e tyre dhe duke kryer abuzime nga më të ndryshmet. Fatkeqësisht ata që mbartin një emër turk dhe kanë gjetur një vend në politikën në Evropë duke diskretitur turqit dhe duke ndarë muslimanët, pasi të përdoren për disa kohë do të zhduken nga arena e politikës si persona pa personalitet dhe identitet. Por ata kanë harruar një gjë se asnjëherë nuk do të cilësohen si belg apo gjermanë, përkundrazi do të jetojnë me damkën si persona që kanë tradhtuar popullin e tyre”, ka vlerësuar Şenocak. Evropa ndodhet në një krizë të madhe sociale dhe kontraktore, në njërin anë flet për të drejtat e njeriut, demokracinë, lirinë dhe në anën tjetër ndan si “armikun brenda nesh” pakicën muslimane që jeton në Evropë në vend që t'i integrojë dhe të respektojë besimet dhe traditat e tyre.

(Anadolu Agency, 3 shtator)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHTE ALFONSI VI ARAGONËS?

Alfonsi V i Aragonës (1396-1458) ishte mbret i Napolit me emrin Alfons I. Pasi zgjeroi sundimin e trashëguar në Aragonë, u bë edhe mbret i Napolit dhe filloi një politikë ekspansioni në Mesdhe në të cilën përfshiu edhe viset ballkanike. Kontaktet e para me sundimtarët shqiptarë janë ato me Gjergj Arianitin. Nga viti 1438 fillojnë kontaktet me Skënderbeun, kurse më 1447 të dy palët shkëmbejnë ambasadorë. Në

këto kontakte shpreheshin interesat e Alfonsit për luftën e shqiptarëve ndaj vërshimit osman, e cila mbronte edhe bregun Adriatik të mbretërisë së Napolit, dhe nga ana tjetër interesat e Skënderbeut për të siguruar mbështetje në këtë luftë. Me këtë qëllim u nënshkrua më 26 mars 1453 midis të dyve traktati në Gaeta. Më në fund Alfonsi hoqi dorë nga planet lindore e si rrjedhojë, edhe nga traktati i aleancës.

VMRO opozitare pritet të vazhdojë me protesta kundër Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Kjo parti nuk do të bojkotojë Referendumin ndërkaq e gjitha garnitura partiake dhe anëtarët e saj, siç flitet kuluareve partiake, do të lihen të lirë të marrin pjesë apo jo në referendum, ashtu sikurse do të jenë të lirë ditën e votimit, por me gjasë vota pritet të jetë kundër në kutitë e votimit për ata që do të dalin

FILLON FUSHATA INTENSIVE PRO REFERENDUMIT

VMRO E VETME KUNDËR TË GJITHËVE!



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 3 shtator - Të hënën më 10 shtator do të fillojë intensivisht fushata për Referendumin që do të mbahet më 30 shtator. Paraprakisht, kauzës qeveritare pro marrëveshjes për emrin me Greqinë pritet ti jep përkrahjen në dimension ndërkombëtar kancelaria gjermane Angela Merkel me vizitën e saj në Shkup të paralajmëruar më 8 shtator. Kjo vizitë është konfirmuar edhe nga Qeveria gjermane. "Kancelarja gjermane, Angela Merkel, të shtunën do të realizojë takim në Shkup. Ende po punohet në program, por mundem të them se kancelarja do të takohet me kryeministrin Zoran Zaev", ka kumtuar zëdhënësi i saj, Shtefen Zajbert. Ai shtoi se fokusi i takimit do të jetë "ndodhitë rajonale, temat bilaterale", derisa Merkel, siç tha Shtefen Zajbert, gjithsesi dëshiron që në vend të formojë përshtypje me rastin e referendumit për çështjen e emrit, i cili do të mbahet në fund të muajit.

"Shpresoj se vizita do të zhvillohet më 8 shtator, por konfirmimi përfundimtar duhet të shpallet nga Gjermania", tha Zaev duke u përgjigjur për gazetarët gjatë vizitës së djeshme në Radishan të

Shkupit. Krahas partive në pushtet LSDM me partitë e koalicionit përfshirë dhe partitë serbe, turke, rome dhe boshnjake, BDI, PDSH, krahu i Afrim Gashit të Lëvizjes BESA që do të bëjnë fushatë pro referendumit më moton "Për një Maqedoni evropiane", edhe partitë shqiptare opozitare Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA e Bilall Kasamit do të bëjnë fushatë aktive pro referendumit. Siç merr vesh KOHA, Aleanca për Shqiptarët tashmë ka vendosur të bëjë fushatë aktive pro referendumit, por se nuk do të mungojnë tonet kritike ndaj partive në pushtet në raport me marrëveshjen me Greqinë në nenet që kanë të bëjnë me identitetin gjuhësor dhe kombëtar.

"Të mërkurën kemi caktuar mbledhje të Kryesisë Qendrore, ku do zgjidhet Kryetari i Shtabit për të udhëhequr kampanjën për referendumin. Gjithashtu në mbledhjen e radhës se KQ, do të shpalojet edhe motoja dhe logo e referendumit. Po ashtu në këtë

mbledhje do të vendoset për oraret e tubimeve, formën dhe mënyrën, se në çfarë forme do ta bëjmë kampanjën e Referendumit. Në Kuvendin Qendror sollëm vendim për ta përkrahur referendumin, por edhe deklaraten adresuar faktorëve ndërkombëtar për domosdëshmërinë e një Marrëveshje politike mes shqiptarëve dhe Maqedonasve me qëllim për të pasur një kohezion të brendshëm politik, i cili do t'i minimizonte dallimet politike, dhe do ti mbyllte ca tema të hapura për shqiptarët siç është çështja e identitetit, e gjuhës e buxhetit me prerje lokale, vendimmarrjes konsensusuale, buxhetit etj", thonë nga departamenti për informim i kësaj partie. Siç shtojnë nga ky departament, për shef të Shtabit zgjedhor do të vendoset njëri nga tre nënkryetarët e partisë: Remzi Memedi, Bujar Abazi apo Vullnet Ferati. Edhe partia tjetër opozitare Lëvizja BESA - krahu i Kasamit do të bëjë fushatë aktive në terren, përmes tubimeve që do të ketë me elektoratin e saj,

dhe në forma tjera mediatike dhe në internet. Sipas burimeve të afërta me këtë parti, shef i Shtabit zgjedhor pritet të zgjidhet sekretari i përgjithshëm i partisë, Arjanit Hoxha, ndërsa motoja do të jetë "Por për NATO dhe BE, si shqiptar, jo si përqindje".

"Qëllimi është që të ketë sukses referendumit që të kemi mundësi në hapjen e kushtetutës të imponojmë korrjigjimet e nevojshme kushtetuese për të hequr termin 20% dhe ta zëvendësojmë me Shqiptarë dhe Gjuhë Shqipe", thonë burime të sigurta partiake. Nga ana tjetër, VMRO opozitare pritet të vazhdojë me protesta kundër Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Kjo parti nuk do të bojkotojë Referendumin ndërkaq e gjitha garnitura partiake dhe anëtarët e saj, siç flitet kuluareve partiake, do të lihen të lirë të marrin pjesë apo jo në referendum, ashtu sikurse do të jenë të lirë ditën e votimit, por me gjasë vota pritet të jetë kundër në kutitë e votimit për ata që do të dalin.



Merkel të shtunën në Shkup

Shkup, 3 shtator - Kryeministri Zoran Zaev dje shprehu shpresë se kancelarja gjermane Angela Merkel do të vijë të shtunën në Shkup, por vuri në dukje se konfirmimi përfundimtar i vizitës, sipas protokollit, duhet të shpallet nga qeveria gjermane.

"Shpresoj se vizita do të zhvillohet më 8 shtator, por konfirmimi përfundimtar duhet të shpallet nga Gjermania", tha Zaev në përgjigje të një pyetjeje të gazetarëve gjatë vizitës në Radishan. Zëdhënësi i Qeverisë gjermane Shtefen Zajbert, siç publikoi agjencia greke e lajmeve ANA-MPA, sot deklaroi se Merkel të shtunën do të realizojë vizitë në Shkup, sepse siç tha ajo dëshiron që të krijojë përshtypjen e saj, duke ardhur në Maqedonia, në prag të referendumit. "Ende po punohet për programin, por mund të them se kancelarja do të takohet me kryeministrin IRJM-së, Zoran Zaev", deklaroi Zajbert dhe shtoi se në fokus të takimit do të jenë "ngjarjet rajonale, temat bilaterale", ndërsa zonja Merkel "gjithsesi që të dëshiron në vetë vendin e ngjarjes të krijojë përshtypjen e saj për referendumin lidhur me emrin e vendit, i cili do të mbahet në fund të muajit".

PARLAMENTI DO T'I KTHEJË PARATË QË NUK DO T'I SHFRYTËZOJË PËR FUSHATË

Shkup, 3 shtator - Qeveria i ka transferuar 80 milionë denarë Parlamentit për fushatën për Referendumin, por financat e dedikuara për 41 për qind e deputetëve nuk do të shfrytëzohen dhe nuk mund të ridedikohen, informojnë nga Parlamenti i Maqedonisë. Në kumtesë thuhet se me kërkesë të Parlamentit për aprovim të mjeteve financiare për fushatën e Referendumit që do të realizohet nga propozuesi i autorizuar të Vendimit për referendum, Qeveria



alokoi mjete në vlerë prej 80 milionë denarë, të transferuara në llogari të posaçme dedikuese Parla-

mentit të Maqedonisë, e cila do të shfrytëzohet për zbatim të fushatës për referendumin. "Financat e

alokuara jashtëzakonisht do të shfrytëzohen vetëm për dedikimin për të cilin janë ndarë mjetet, gjegjësisht për fushatën e cila do të realizohet nga ana e 71 deputetëve të cilët janë prononcuar se janë në koalicionin PËR referendumin, që paraqet 59 për qind nga koha për reklamim të autorizuar të paguar në media", thuhet në kumtesë. Nga kabineti i kryetarit të Parlamentit informojnë se pjesa e mbetur nga financat e alokuara për fushatën e referendumit, gjegjësisht financat

e dedikuara për 41 për qind të deputetëve të cilët në letërën deri te kryetari i Parlamentit u prononcuan se kërkojnë mjete për fushatë të re-dedikohen për qëllime të tjera, të njëjta nuk mund të ridedikohen për qëllime të tjera, gjegjësisht të njëjta do të mbeten të pashfrytëzuara. Ndryshe, grupi i deputetëve i VMRO-DPMNE-së kërkoi nga kryetari i Parlamentit që të hollat për fushatë të parapara për to të shfrytëzohen për projekte në arsim, bujqësi, mbrojtje...

Për shumë vjet, debati për kufijtë në Ballkan ishte një temë gati se e ndaluar për politikanë e liderë shtetëror të këtij rajoni. Hapja e çështjes së kufijve, në vazhdimësi shihej si një problematikë, e cila besohej se nuk do të përfshinte vetëm një apo dy shtete, ngase besohej se do të prodhonte efekte zinxhir tek të gjitha shtetet fqinje

Prishtinë, 3 shtator - Shteti më i ri evropian, Kosova, e cila shpalli pavarësinë e saj në koordinim me Perëndimin, e kishte përcaktuar në Kushtetutën e saj e cila buron nga Pakoja e Ahtisaarit, si marrëveshje gjithëpërfshirëse për statusin, se Kosova nuk mund të ndahet e as të bashkohet me një shtet tjetër. Duke e ruajtur këtë parim, presidentët e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vučić kanë nxjerrë formulën politike sipas të cilës nuk ka ndarje e shkëmbim të territorit, por mund të ketë korrigjim të kufirit.

Por, një ide e tillë përveç që shtron dilemën se sa mund të realizohet, shtron edhe pyetjen se çfarë efektësh mund të kishte për vendet e rajonit? Andaj, ideja e korrigjimit të kufirit, është komentuar në Prishtinë, Beograd, Shkup e Tiranë. Politologu nga Prishtina, Ramush Tahiri, thotë se nëse marrëveshja do të arrihet me vullnet të dyja palëve, atëherë mund të jetë e pranueshme edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Kurse çështje tjetër, nënvizon ai, mbetet nëse ajo marrëveshje do të merrej si model edhe nga shtetet tjera me probleme të ngjashme.

"Nëse është arritur një lloj pjekurie që serbët dhe shqiptarët ta bëjnë një kufi të ri, duke e ndryshuar këtë kufirin që është tash mes Kosovës dhe Serbisë, të jetë një kufi i pranueshëm për të dyja palët, që nuk sjell shpërngulje të popullatës nga njëra anë dhe anën tjetër dhe nuk krijon shtete etnike, atëherë është i drejtë dhe duhet të ndikoj qetësisht në vende tjera të Ballkanit", thotë Tahiri. "Pra, nuk ka asnjë arsye që të ndikojë në Maqedoni, sepse nuk ka interes për kufizimin nacional ose nuk e ka shprehur ajo popullatë. Gjithashtu në Bosnje kanë qenë kushtet të caktuara të luftës, por që Bosnja duhet të bëjë shtet i dy entiteteve dhe tre kombeve", thekson Tahiri. Por, ndryshe mendon, Edward Joseph, profesor në Universitetin John Hopkins, i cili ka qenë në misionet ndërkombëtare në Ballkan gjatë dhe pas luftës, ka thënë për Shërbimin për Ballkanin të Radios Evropa e Lirë se ideja për shkëmbimin e territoreve nuk është e re. Por, sipas tij, njerëzit nuk

"KORRIGJIMI I BALLKANIT"



LISEN BASHKURTI

Vendet e rajonit kanë nevojë të konsolidojnë paqen, dhe paqen nuk e konsolidon prekja e kufijve. Ideja, do të thosha se nuk është e drejtë edhe nga pikëpamja e së drejtës, sepse këtu kemi të bëjmë me një proces shtetesh të njohura, edhe Kosova është shtet i pavarur, i njohur ndërkombëtarisht, mbi 116 shtete e kanë njohur tashmë



RAMUSH TAHIRI

Nëse është arritur një lloj pjekurie që serbët dhe shqiptarët ta bëjnë një kufi të ri, duke e ndryshuar këtë kufirin që është tash mes Kosovës dhe Serbisë, të jetë një kufi i pranueshëm për të dyja palët, që nuk sjell shpërngulje të popullatës nga njëra anë dhe anën tjetër dhe nuk krijon shtete etnike, atëherë është i drejtë dhe duhet të ndikoj qetësisht në vende tjera të Ballkanit

janë në gjendje t'i shohin pasojat nga realizimi eventual i një ideje të tillë, madje edhe në rast se Prishtina dhe Beogradi merren vesh për territorin të cilin duhet ta shkëmbejnë.

"Edhe nëse Beogradi dhe Prishtina pajtohen për madhësinë e territorit që duhet ta shkëmbejnë, duhet t'i kemi parasysh pasojat ndaj Maqedonisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Pse shqiptarët në Maqedoni, të cilët përbëjnë 25 për qind të popullsisë së këtij shteti, nuk do të dëshironin që t'u bashkohen shqiptarëve tjerë në shtetin shqiptar - në



ALAJDIN DEMIRI

Këmbimi i territoreve në Kosovë do të ishte alarm që të ndodhte e njëjta edhe në Maqedoni, që do të thotë që Maqedonia perëndimore, aty ku jetojnë shumica shqiptare, duhet ose të shpallë pavarësinë e vet ose të ketë një bashkëngjiturje me Shqipërinë apo Kosovën. Mirëpo, nga ana tjetër, as Kosova dhe as Shqipëria nuk janë të përgatitura dhe nuk kanë si duket as interes që këtë ta pranojnë

rast të shkëmbimit të territoreve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës?", theksoi Joseph. Sipas tij, në rast se bashkësia ndërkombëtare do ta lejonte shkëmbimin e territoreve dhe veriu Kosovës i bashkohet Serbisë, atëherë nuk ka logjikë që të thuhet se këtë nuk mund ta bëjë edhe Republika Serbe në Bosnjë.

Në anën tjetër, profesori Alajdin Demiri, ish-deputet dhe ish-ambasador i Maqedonisë në Zvicër, thotë se korrigjimi i kufirit, që sipas tij do të përfundonte me shkëmbim territorësh, patjetër që do të ndikonte në gjithë rajonin. Ai thotë

se në rastin e Maqedonisë, jo vetëm nga shqiptarët, por edhe te politikanët maqedonas qarkullon ideja e ndarjes, nëse nuk mund të vendoset bashkëjetesa mes shqiptarëve e maqedonëve me një shtet.

"Këmbimi i territoreve në Kosovë do të ishte alarm që të ndodhte e njëjta edhe në Maqedoni, që do të thotë që Maqedonia Perëndimore, aty ku jetojnë shumica shqiptare, duhet ose të shpallë pavarësinë e vet ose të ketë një bashkëngjiturje me Shqipërinë apo Kosovën. Mirëpo, nga ana tjetër, as Kosova dhe as Shqipëria nuk janë të përgatitura dhe nuk kanë si duket as interes që këtë ta pranojnë. Andaj, ky është një problem, si duket i largët dhe i hershëm për arsye se edhe pse 20 vjet e këndej Serbia nuk e njeh Kosovën, ende siç po shihet kushtet nuk janë të pjekura për një proces të tillë, të njohjes", thekson Demiri. Demiri thotë po ashtu se skenarët e ndryshimit të kufijve mund të jenë edhe shumë të rrezikshëm për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Po ashtu, edhe Lisen Bashkurti, ish-përfaqësues i Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ka thënë për Radion Evropa e Lirë se ideja e hedhur në opinionin publik për debat mbi ndryshimin apo korrigjimin e kufijve, apo shkëmbimet territoriale nuk është një ide realiste, veçanërisht për faktin sepse Ballkani, thotë ai, është një rajon ende shumë delikat për çështjet e sigurisë dhe stabilitetit. Ai e sheh një ide



EDWARD JOSEPH

Edhe nëse Beogradi dhe Prishtina pajtohen për madhësinë e territorit që duhet ta shkëmbejnë, duhet t'i kemi parasysh pasojat ndaj Maqedonisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Pse shqiptarët në Maqedoni, të cilët përbëjnë 25 për qind të popullsisë së këtij shteti, nuk do të dëshironin që t'u bashkohen shqiptarëve tjerë në shtetin shqiptar - në rast të shkëmbimit të territoreve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës?

të tillë edhe si kërcënim për rajonin dhe mundësi për shtrirjen e ndikimit të faktorëve tjerë ndërkombëtar në rajon. "Vendet e rajonit kanë nevojë të konsolidojnë paqen, dhe paqen nuk e konsolidon prekja e kufijve. Ideja, do të thosha se nuk është e drejtë edhe nga pikëpamja e së drejtës, sepse këtu kemi të bëjmë me një proces shtetesh të njohura, edhe Kosova është shtet i pavarur, i njohur ndërkombëtarisht, mbi 116 shtete e kanë njohur tashmë. Kështu që në të gjitha pikëpamjet, nga konteksti i zhvillimeve të brendshme në Kosovë dhe kushteve delikate që kanë vendet në rajonin tonë, mendoj se ideja e hedhur nga Thaçi nuk është realiste", thotë Bashkurti. Sidoqoftë, debati për dhe kundër idesë së korrigjimit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nuk është shtrirë vetëm te politikanë e publicistë në rajon, por edhe te figura e personalitete të shumta politike e publike nga shtetet më me ndikim sot në botë. (REL)

MOGHERINI TËRHIQET

Diplomatja e BE-së, Federica Mogherini, në fillim dyshohej se ishte dakord për një shkëmbim territorësh mes Serbisë dhe Kosovës. Por në Vjenë ajo u tërhoq. "Në radhë të parë duam të mbrojmë dhe të nxisim dialogun e filluar ndërmjet dy kryeqyteteve", tha ajo. Ajo shtoi se nuk donte t'i pengonte bisedimet e vështira, duke i përcaktuar rezultatet që më parë, dhe konfirmoi takimin e saj me dy liderët, Vuçiq dhe Thaçi, të premtën e ardhshme, më 7 shtator, në Bruksel. Mogherini përpiqet të mbështesë "çdo rezultat" të këtyre bisedimeve, me kusht që ai të jetë në përputhje me të



drejtën ndërkombëtare dhe atë europiane. Dhe kjo do të thotë, sipas saj, refuzim të çdo rezultati që synon shtete të pastra etnikisht - një refuzim i shprehur me gjuhën e komplikuar të diplomacisë ndaj planeve për "spastrime etnike" në territoret e dy shteteve. Cili është qëllimi i negociatave të saj atëherë? Duam një marrëveshje, thotë Mogherini, që do të zgjidhte të gjitha "problemet e hapura" dhe ajo përfshin këtu në mënyrë të qartë edhe njohjen e Kosovës. Plani kohor është ambicioz, sepse ajo shpreson të arrijë një sukses brenda muajve të ardhshëm, gjithsesi deri në fund të këtij viti.

“PËRQESHJA ME KRISHTIN”, PROJEKTI I FUNDIT ANTISHQIPTAR

DISTANCOHET AGJENCIA DHE KULTURA, BOJAXHI NUK MËRZITET PËR REAGIMET

Përmbajtja e filmit dhe mesazhet janë cilësuar si të dëmshëm për marrëdhëniet ndëretnike dhe ofenduese për pjesën shqiptare, por pa saktësuar se çfarë masash mund të merren, dhe nëse ky film do të vazhdojë të shfaqet në festivale brenda dhe jashtë vendit, ashtu siç po ndodh prej gati dy vjetësh me filmin “Kur dita s’kishte emër”, një projekt tjetër provokues. Regjisori Bojaxhi ndërkohë thotë se nuk i bëhet vonë “nëse dikujt do t’i pëlqejë ose jo, apo edhe nëse do të kuptohet drejtë”



Përmbajtja e filmit dhe mesazhet janë cilësuar si të dëmshëm për marrëdhëniet ndëretnike dhe ofenduese për pjesën shqiptare. Ministri Ademi ka thënë se nuk do të lejojë të financohen projekte të tilla me para nga buxheti i shtetit. Projekti i miratuar në vitin 2015 mban aprovimin e ish-drejtuësve dhe anëtarëve të Agjencisë së Filmit, mes tyre asnjë emër shqiptar.

Ademi ka sqaruar se me Ligjin e ri të Kulturës, këto çështje do të zgjidhen duke krijuar barrierat e nevojshme për të mos lejuar financimin e projekteve që janë në kundërshtim me interesin publik. Drejtori i Agjencisë së Filmit, Gorjan Tozija, ka thënë se ky vendim për të kontrolluar tematikën dhe përmbajtjen, nuk duhet të kuptohet si censurë ndaj kineastëve, por se filmi duhet të distancohet nga ndikimi politik.

“Komisionet dhe inspektorët do të kontrollojnë të gjitha detajet rreth vendimit për financimin e këtij filmi. Edhe pse kam parë vetëm trajlerin dhe kam lexuar dokumentacionin për këtë film, prapëseprapë mund të konstatoj se ky film është një provokim, një kaprico e regjisorit”, ka thënë Tozija. Premiera e filmit është dhënë pak ditë

më parë (30 gusht) në Festivalin e Filmit në Montreal, Kanada. Lidhur me episodet dhe skenat me ushtarët e UÇK-së, regjisori thotë se i është referuar ngjarjeve në 2001, betejës së Radushës dhe punëtorëve të Mavrovës, si vitit që shënoi kthesën e madhe për Maqedoninë. Filmi merr spunto nga vrasja e të riut maqedonas Vanço Karanfilovit në Tetovë, i qëlluar teksa luante basketboll.

“Këto janë tre ngjarje të vërteta që ne i përpunam për të treguar se ndonjëherë instrumentet dhe mjetet interpretohen si në funksion të lirisë, por ndonjëherë edhe si mjetet për terror. Ideja e filmit është të tregojmë se asnjë terror s’ka sjellë asgjë të mirë, por ka krijuar dhe lindur terror të ri. Prandaj edhe nëntitulli i filmit është: Secili kundër secilit - Zoti kundër të gjithëve! Tentuam të tregojmë se kur kthehemi kundër të gjithëve kushedi se ku do përfundojmë”, ka deklaruar regjisori për mediat pak ditë përpara shfaqjes së premierës. Sa i takon efekteve dhe reagimit të publikut dhe kritikës, Bojaxhi thotë se nuk i intereson “nëse dikujt do t’i pëlqejë ose jo, apo edhe nëse do të kuptohet drejtë”.

KRONIKË

Ndalohen 6 këngëtare dhe valltare

Mbrëmjen e 1 dhe 2 shtatorit, nga ora 23.00 deri në orën 3.00 pas mesnate, pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë kanë kryer një aksion kontrolli në objektin hotelierik pa firmë i lokalizuar në rrugën “Boris Kidriç”, në Tetovë, pronë e 25-vjeçarit me iniciale L.A nga Reçica e Vogël. Pas kësaj në këtë objekt hotelierik janë ndaluar 6 shtetas të huaj prej të cilëve katër femra këngëtare dhe valltare si dhe dy meshkuj muzikant të cilët kanë argëtuar mysafirët. Të gjashtë shtetasit e Shqipërisë janë arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor në Tetovë, ndërsa më pas janë dorëzuar në sektorit për kriminalitet ndërkufitar të huaj dhe riatdhesim për procedurë të mëtutjeshme. Për shkak të keqpërdorimit të qëndrimit turistik, dje rreth orës 16 janë deportuar në shtetin e tyre amë, njofton Sektori për punë të brendshme në Tetovë përmes një kumtese me shkrim.

Prishet rendi dhe qetësia në kishë

Të dielën rreth orës 14.30 minuta 38-vjeçari me iniciale B.M nga fshati Çellopek ka denoncuar se 29-vjeçari me iniciale B.S në një kremtim të kishës ka prishur rendin dhe qetësinë publike me anë të gjuajtjes me armë zjarri. Sipas policisë në vendin e ngjarjes menjëherë janë dërguar pjesëtarë të policisë nga Sektori për punë të brendshme në Tetovë.

Deri në arritjen e pjestarëve të policisë në vendin e ngjarjes B.M fizikisht është sulmuar nga B.S. Pas kësaj B.S dhe N.B 25-vjeçarë fizikisht kanë sulmuar personin me iniciale B.M ndërsa N.M ka penguar pjesëtarët e policisë në marrjen e veprimeve zyrtare. Q të tre si dhe N.B 29-vjeçarë nga i njëjti fshat janë arrestuar dhe po punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Koha

Evis HALILI

Shkup, 3 shtator - Ministria e Kulturës dhe Agjencia e Filmit janë distancuar së bashku nga filmi “Përqeshja me Krishtin”, me regji të Jani Bojaxhi, pas skandalit që shkaktoi publikimi i trajlerit këto ditë, skenave të dhunshme me ushtarët të UÇK-së. Për të vërtetuar nëse është shkelur Rregullorja e filmit dhe vetë Ligji për filmin, ky film do të kalojë edhe një herë në Ilupën e inspektorëve të Ministrisë së Kulturës. Kështu kanë deklaruar ministri i Kulturës, Asaf Ademi dhe drejtori i Agjencisë së Filmit, Gorjan Tozija, por pa saktësuar se çfarë masash mund të merren, dhe nëse ky film do të vazhdojë të shfaqet në festivale brenda dhe jashtë vendit, ashtu siç po ndodh prej gati dy vjetësh me filmin “Kur dita s’kishte emër”, një projekt tjetër provokues, i ngjashëm dhe i financuar nga Agjencia së Filmit.

TRE TË ARRESTUAR PËR VRASJEN MAKABRE NË DIBËR

E bija dyshohet se vrau prindërit dhe të motrën

Dibër, 3 shtator - Prokuroria Themelore Publike e Gostivarit ka njoftuar se janë arrestuar tre persona për vrasjen makabre në Dibër që ndodhi para një jave, ku u vranë me armë zjarri gruaja, burri dhe vajza e tyre 14-vjeçare. “Në lidhje me vrasjen e trefishtë në Dibër, Prokuroria Themelore Publike e Gostivarit, si kompetente për të vepruar në lëndë, intensivisht i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për konstatimin e përgjegjësisë penale dhe për mbledhjen e dëshmive. Deri në

këtë moment, tre persona janë privuar nga liria dhe për të njëjtët është shqiptuar masë afatshkurtër e paraburgimit prej 48 orëve. Pas skadimit të këtij afati, do të silltet vendim prokurorial për veprim të mëtutjeshëm”, thonë nga Prokuroria. Nga MPB kanë thënë se nuk mund të japin detaje për rastin, por se po punojnë për zbardhjen e të njëjtit. MPB, njëkohësisht njofton se pas mbarrimit të hetimeve, do të informohet opinioni për epilogun. Jozyrtarisht, djenëpër media

kanë qarkulluar informata për një kthesë në rastin e vrasjes së trefishtë, gjegjësisht thuhet se tani po akuzohet vajza e madhe e të vrasurëve dhe jo një pjesëtar i një familjeje tjetër dibrane, sikur është thënë paraprakisht në opinion. Autore e vrasjes së trefishtë, e cila ndodhi në Dibër në familjen Pocesta, është vajza e tyre e madhe, e cila gjithashtu jetonte me ata në Itali, transmetojnë mediat online, duke iu referuar policisë. Jozyrtarisht mësohet se B.P. (25), një ditë para ndodhjes së kri-

mit ka hyrë në Maqedoni dhe ditën e ndodhjes së krimit ka lëshuar kufirin e Maqedonisë, informacion ky i konfirmuar nga sistemi elektronik kufitar. Bashkë me vajzën e madhe të familjes Pocesta B.P, dyshohet edhe për dy persona të tjerë të cilët kanë ndihmuar vrasjen, personi F.G nga Gostivari i cili për policinë është emër i njohur si person problematik ka qenë transportuesi i vajzës nga kufiri deri në Dibër. Personi tjetër i përfshirë si i dyshuar në vrasje është nipi i F.G, personi me

iniciale V.K, i cili u arrestua dje nga policia dhe sot ka pranuar në sallë të gjyqit se ai i ka shitur vajzës së familjes Pocesta, B.P armën me të cilën është kryer krimi. Sipas informacioneve jozyrtare aktualisht sapo ka mbaruar marrja në pyetje në Gjykatën Themelore në Dibër është caktuar masa e paraburgimit 30 ditor. Përndryshe viktimat e vrasjes makabre që tronditi Dibër janë bashkëshortët Pocesta, Nazmija 53 vjeçe, Amiri 54 vjeçar si dhe e bija e tyre e mitur, Anila 14 vjeçe. (U.H)

Në fund gjenden edhe Bullgaria, Rumania, Sllovakia, Kroacia, Polonia, Greqia, ndërsa vende të cilat kanë arritur dhe tejkaluar 15 për qind janë vendet nordike Suedia, Danimarka, Finlanda, Franca, Holanda, Luksemburgu, Estonia, Austria dhe Britania e Madhe

Shkup, 3 shtator - Maqedonia, edhe krahas asaj që është kandidatë për anëtarësim në BE dhe pretendon t'i ndjekë trendet arsimore evropiane dhe t'i harmonizojë standardet arsimore evropiane, megjithatë është në fund të vendeve evropiane sipas pjesëmarrjes së të rriturve në proceset e mësimin të përjetshëm me rreth dy e gjysmë për qind.

Maqedonia, si edhe vendet e tjera të BE-së ballafaqohet me efektet nga globalizimi, problemet e shkaktuara nga trendet demografike siç është plakja e popullatës, ndryshimi enorm i tregut të punës i shkaktuar nga zhvillimi i shpejtë teknologjik, përqindja e madhe e papunësisë, emigrimi i popullatës... E gjithë kjo e thekson nevojën për ndërtim të shoqërive të bazuara në dije, ku mësimi i përjetshëm do të jetë koncept kryesor në të cilin do të mbështetet i gjithë sistemi edukativo-arsimor dhe kultura e të jetuarit. Në raportin e Komisionit Evropian "Arsim dhe trajnim 2020" theksohen tetë indikatorë të cilët vendet anëtare duhet t'i përmbushin deri në vitin 2020 midis të cilëve edhe indikatorin për pjesëmarrje të të rriturve me të paktën 15 për qind në ndonjërin nga format e mësimin të përjetshëm. Ky indikator është një nga treguesit se vendi është në fundin e listës së vendeve evropiane sipas pjesëmarrjes së të rriturve

MAQEDONIA LARG TRENDEVE EVROPIANE

TË FUNDIT NË EVROPË ME MËSIMIN E PËRJETSHËM



në mësimin e përjetshëm me rreth dy për qind.

Në fund gjenden edhe Bullgaria, Rumania, Sllovakia, Kroacia, Polonia, Greqia, ndërsa vende të cilat kanë arritur dhe tejkaluar 15 për qind janë vendet nordike Suedia, Danimarka, Finlanda, Franca, Holanda, Luksemburgu, Estonia, Austria dhe Britania e Madhe. Profesoresha e shkencave pedagogjike Elena Rizova nga Instituti për Pedagogji në Fakultetin Filozofik në Shkup, në bisedë për MIA-n thotë se megjithatë gjatë disa viteve të kaluara në Maqedoni është bërë hap përpara me përgatitjen e "Strategjisë për mësim të përjetshëm 2017-2020", që sipas saj

duhet të paraqesë bërthamë rreth të cilës do të gravitojnë të gjithë dokumentet e tjera arsimore strategjike dhe e cila një orë e më parë duhet të miratohet nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

"Indikator pozitiv është edhe ajo që Qendra për arsim të të rriturve numëron gjithnjë e më shumë programe të verifikuara për arsim të të rriturve nga sfera të ndryshme që u mundësojnë kuadrove me kualifikim të ulët të përfitojnë kualifikim më të lartë nga një sferë e caktuar të cilën e kanë me interes", thotë prof. Rizova. Potencoit edhe se çdoherë e më shumë organizatat dhe trupa joqeveritare e promovojnë mësimin

e përjetshëm përmes ofrimit të programeve nga karakteri joformal të cilat kanë për qëllim ta përmirësojnë jetën dhe t'i përparojnë njohuritë dhe aftësitë e njerëzve.

"Në arsimin formal, të Fakultetit Filozofik në Shkup dhe Institutit për Pedagogji në dy programe studimore (pedagogji dhe andragogji) është përfaqësuar lënda mësimi i përjetshëm dhe atë në cikël të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve. Me atë u mundësohet profileve arsimore ta zbatojnë këtë koncept në punë praktike", deklaroi Rizova. Thotë se në vend qeveris mendimi se mësimi i përjetshëm është primat vetëm i njerëzve të rritur, që paraqet interpretim të

gabuar të këtij koncepti. Sipas Komisionit Evropian dhe UNESCO-s, mësimi i përjetshëm kuptohet "çdo mësim i cili zhvillohet gjatë jetës së njeriut me qëllim të përmirësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave në mendimin personal, qytetar, social dhe të punës. "Definimi i tillë i jep dimension më të ndryshëm, më të gjerë të mësimin jetësor i cili mund të zhvillohet në kontekst formal, joformal ose informal, duke vënë theks në kohezionin dhe përfshirjen sociale, vetrealizimin dhe qytetërimin aktiv dhe përshtatshmërinë, ndaj rrethinës së ndryshueshme të punës dhe mësimin. E zbatuar në jetën e përditshme, ajo do të vlen-te me përfitimin e kualifikimit të lartë të caktuar, ruajtjen e gjuhës së huaj, punën me kompjuter, por edhe fitimin e aftësive të thjeshta motorike si ngasja e biçikletës, ose vallëzimi, përgatitja e ushqimeve etj".

Rizova megjithatë vlerëson se që të përmirësohet gjendja me inkluzionin e të rinjve në ndonjërin prej formave të mësimin të përjetshëm dhe arritjen e indikatorëve të projektuar të BE-së për vitin 2020, duhet sistemi i përgjithshëm arsimor të vihet në mënyrë që ta kultivojë dhe të jetë në funksion të këtij koncepti, pasi mësimi i përjetshëm nuk është vetëm trend global, por nevojë për shoqëritë bashkëkohore. (R.B)

KRSK ME APEL PËR VITIN E RI SHKOLLOR

Kujdes kur vozisni afër shkollave

Shkup, 3 shtator - Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacion (KRSK) apelon deri te shoferët me kujdes t'i drejtojnë automobilat e tyre veçanërisht në zonat ku ka kopshte dhe shkolla. KRSK të gjithë nxënësve u dëshiron vit shkollor të suksesshëm dhe i përkujton me kujdes, përgjegjësi, dhe të sigurt të marrin pjesë në komunikacion. KRSK i përkujton shoferët për praktikën e përditshme në të cilën fëmijët pa prituri vrapojnë në rrugë, si dhe në obligimin ligjor, në zona të shkollave dhe kopshteve të zvogëlohet shpejtësia e lëvizjes dhe të rritet vigjilenca dhe kujdesi. "Siguria e fëmijëve në komunikacion është përgjegjësi e të rriturve, potencojnë prej atje.

Në kumtesën e KRSK-së citohet fakti se më se i njohur është fakti se, fëmijët më të rinj se 12 vjet, nuk e vlerësojnë sa duhet largësinë e automobilave dhe kohën e nevojshme ta kalojnë rrugën. KRSK i përkujton prindërit se janë shembulli personal i fëmijëve të cilët ata i shohin çdo ditë dhe se duhet pa kusht dhe tërësisht t'i respektojnë rregullat dhe dispozitat në komunikacion.

"Të dhënat statistikore tregojnë se fëmijët shpesh herë pësojnë në aksidente si udhëtarë. Në atë drejtim, KRSK përkujton në obligimin ligjor sipas të cilit, fëmijët të cilët nuk i kanë mbushur 12 vjet, nuk guxojnë të ulen në ulësen e përparme, si dhe për obligi-

min e shfrytëzimit të rripit të sigurisë në të gjitha ulëset dhe ulëse për fëmijët të moshës deri në 5 vjet (madje edhe atëherë kur udhëtimi është e shkurtër)", potencohet në kumtesë. Nga KRSK potencojnë se çdo prind përgjegjës, përveç obligimeve të tjera, me fillimin e vitit shkollor, obligohet që fëmijës së tij t'ia tregojë dhe t'ia përsërisë rrugën më të sigurt nga shkolla deri në shtëpi, t'i potencojë fëmijës për rreziqet potenciale dhe kërcënimet në komunikacion dhe t'ia sqarojë dhe përsërisë rregullat më të rëndësishme dhe dispozitat në komunikacion. Për mbrojtje shtesë të fëmijëve, në kushte të natës dhe në kushte të dukshmërisë së zvogëluar, rekomandohet mbajtja

e veshjes së ndritshme, shfrytëzimi i materialeve reflektuese të veshjes, çantat e shkollës dhe ngjashëm.

KRSK rekomandon fëmijët të cilët shkojnë vetëm në shkollë, pa shoqërim të prindërit ose të ndonjë personi tjetër të rritur, të përdorin ruta të sigurta të këmbësorëve dhe gjithmonë të ecin nëpër trotuare. Gjatë kalimit të rrugës, gjithmonë të ecin nëpër vendkalimin e shënuar për këmbësorë, ashtu që së pari do të shikojnë në të majtë pastaj në të djathtë dhe sërisht në të majtë para se ta kalojnë rrugën. Gjithmonë të përkujtohen në këshillat e prindërve dhe mësimdhënësve. Në vendet e populluara gjithmonë të ecin

nëpër trotuare dhe nëpër shtigjet për këmbësorë. Nëse nuk ka, atëherë duhet të ecin sa më afër pranë rrugës. "Nxënësit, kur udhëtojnë me autobus, pas daljes nga autobusi, gjithmonë duhet të presin së pari të kalojnë autobusi, madje pastaj ta kalojnë rrugën. Vrapimi në rrugë para ose pas autobusit është shumë i rrezikshëm. Fëmijët duhet ta dinë se, nuk guxojnë të dalin në rrugë kur lëvizin mes automobilave të parkuar sepse janë të vegjël dhe shoferët nuk mund t'i vërejnë para se të dalin në rrugë. Fëmijët gjithmonë duhet të jenë të kujdesshëm kur lëvizin në rrugë ose në trotuar", citohet në rekomandimin e Këshillit Republikan. (O.XH)

OEM DHE OEK ME POROSI PËR PRISHTINËN DHE SHKUPIN

NËSE NUK NA NDIHMONI, TË PAKTËN MOS NA PENGONI

Sa i përket Kosovës, është për ta pasur lakmi se si për 10 vite pavarësi, ka arritur të ndërtojë infrastrukturë që ka lidhur Kosovën me Shqipërinë, tani së shpejti me Maqedoninë dhe në të ardhmen - edhe me Serbinë. Kjo është një mundësi e mirë për fuqizimin e sektorit privat nga vendet e rajonit të kërkojnë nga qeveritë e tyre se si duhet të përkrahët biznesi privat dhe industria, zhvillimi ekonomik apo ndërtimi i infrastrukturës”, tha Azeski

Koha Zejnulla VESELI

Kaçanik, 3 shtator - Oda Ekonomike e Maqedonisë (OEM) dhe Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), janë ndër odat më të radha në rajon që kanë traditë të mirë bashkëpunimi më të gjatë se sa vetë shtetet dhe pikërisht kjo na bënë të jemi lider nga vendet e rajonit. Dhe në të ardhmen, do të punojmë më shumë në avancimin e aktiviteteve si në fushat ekonomike, por edhe ato politike. Kështu deklaruan Berat Rukiqi, kryetari i OEK-së dhe Branko Azeski, kryetari i OEM-së në konferencën e përbashkët në vendin ku mbaron segmenti i përfunduar i autostradës Prishtinë-Shkup, gjegjësisht në fshatin Doganaj të Kaçanikut. Duke folur për procesin e integrimi të Kosovës dhe Maqedonisë në Bashkimin Evropian (BE) dhe mundësitë e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, Branko Azeski u shpreh se ndërtimi i autostradës do të ndikojë në lehtësimin e punës së bizneseve. “Po të ishim këtu para 10 vitesh, askush nuk do ta besonte se Kosova do ta ndërtonte këtë rrugë. Megjithatë, janë vënë themelet që deri në fund të vitit autostrada do të përfundojë. Që i bie se më në fund, fjalët janë shndërruar në vepra”, tha Azeski. Ai potencoi se brenda 5 viteve, eksportet midis shteteve do të dyfishohen, nëse rregullohen problemet politike mes shteteve të Ballkanit. “Me gëzon fakti se takimin e sotëm e organizuam në terren e jo ulur në kolltukët e zyrave. Ky le të jetë një



udhërrëfim për të gjithë funksionarët e lartë shtetëror, si dhe kryetarëve të Odave ekonomike të rajonit të dalin në terren dhe të punojnë dhe sa më pak të qëndrojnë nëpër kolltukët e tyre, sepse ky lloj veprimi nuk ka sjell asfarë dobie as për shtetin, po as edhe për bizneset”, deklaroi Azeski duke u dërguar mesazh të dyja elitave politike në rajon që t’i përshpejtojnë proceset, sepse bizneset nuk presin.

“Qeveritë e rajoneve, e sidomos Qeveria e Maqedonisë të ketë si prioritet tre gjëra: zhvillimin e industrisë, rritjen e eksportit dhe ndërtimin e infrastrukturës. Në këtë drejtim, sa i përket Kosovës, është për ta pasur lakmi se si për 10 vite pavarësi, ka arritur të ndërtojë infrastrukturë që ka lidhur Kosovën me Shqipërinë, tani së shpejti me Maqedoninë dhe në të ardhmen - edhe me Serbinë. Kjo është një mundësi e mirë për fuqizimin e sektorit privat nga vendet e rajonit të kërkojnë nga qeveritë e tyre se si duhet të përkrahët biznesi privat dhe industria, zhvillimi

ekonomik apo ndërtimi i infrastrukturës”, tha Branko Azeski, kryetari i OEM-së.

Edhe Berat Rukiqi apeloi te të gjitha vendet e rajonit, e sidomos deri të Qeveria e Maqedonisë që sa më shpejtë të fillojë me ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë, sepse vetëm kështu mund të bëhet më shumë për zhvillimin ekonomik të të dyja vendeve, dhe prioritet le të jenë më shumë investimet në infrastrukturë.

“Maqedonia është ndër fqinjët që nuk kemi asnjë problem të natyrës ekonomike. Prandaj duhet të bëjmë më shumë në fushën e fuqizimit të investimeve dhe infrastrukturës. Për t’i larguar barrierat ekonomike, duhet më shumë investime në infrastrukturë”, deklaroi Rukiqi, duke shtuar se politika e të dyja shteteve është pengesë e zhvillimit ekonomik, prandaj nëse këto të fundit nuk mund të ndihmojnë në zhvillim, të paktën të mos jenë pengesë.

“Politikat aktuale kanë penguar bashkëpunimin ekonomik midis dy vendeve, si dialogu mes

Kosovës dhe Serbisë dhe Referendumi për çështjen e emrit në Maqedoni. Si sektor ekonomik po ecim më shpejt se politika. Por problemi qëndron tek politikat e dy shteteve, të cilat janë pengesë për zhvillimin ekonomik. Nuk duhet asnjë proces ta pengojë zhvillimin ekonomik. Nëse qeveritë nuk mundin të ndihmojnë biznesin, të mos i bëhen pengesë asaj. Ta bëjmë këtë vend më atraktiv dhe në të njëjtën kohë të krijojmë kushte që këto zhvillime të hyjnë në zhvillimin ekonomik të vendeve”, deklaroi Berat Rukiqi, kryetar i OEK-së.

Ndryshe, ndërtimi i autostradës që lidh Prishtinën dhe Shkupin në anën e Kosovës ka përfunduar deri në afërsi të fshatit Doganaj dhe kanë mbetur rreth 25 kilometra, ku dhe janë vendosur themelet, për të përfunduar ndërtimi i plotë i saj deri në kufirin me Maqedoninë. Ndërsa në anën maqedonase, ende nuk kanë filluar punimet për ndërtimin e kësaj autostrade që do të lidh kryeqytetet e dy vendeve fqinje.

Derivatet shtrenjtohen deri në 1.5 denarë

Shkup, 3 shtator - Çmimi me pakicë i benzinave dhe dizelit nga mbëmë në mesnatë shtrenjtohet nga një deri në 1.5 denarë, vendosi Komisioni Rregullator për Energjetikë. Sipas Vendimit, çmimi i ri i Eurosuper BS-95 rritet për një denar dhe do të jetë 72 denarë për një litër, Eurosuper BS-98 rritet për 1.5 denarë dhe do të jetë 74 denarë për një litër. Për 1.5 denarë rritet edhe çmimi i Eurodizelit dhe ai do të shitet për 64.5 denarë për një litër. Rritet çmimi edhe i Vajit ekstra të lehtë për amvisërinë për 1.5 denarë dhe do të shitet nga 53 denarë për një litër. Çmimi me pakicë i mazutit rritet për 0.951 denarë dhe do të jetë 34 denarë për një kilogram. Çmimi mesatar i naftës së papërpunuar në tregun botëror në 14 ditët e kaluara ishte 74.5 dollarë për barel, ndërsa kursi i denarit në krahasim me dollarin ishte 53.62 denarë.

Kërkohen mbi 7000 punëtorë

Shkup, 3 shtator - Në kuartalin e dytë të dhënat statistikore tregojnë se shkalla e vendeve të lira të punës është 1.44 për qind, gjegjësisht se ka pasur 7199 vende të lira të punës. Shkallë më të lartë të vendeve të lira të punës ka sektori objekte për banim dhe veprimtari servisuere me ushqim 2.59 për qind ose 858 vende të lira të punës, ndërsa më e vogël është shkalla në sektorin furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicioner, në të cilin është 0.24 ose 20 vende të lira të punës. Subjektet afariste me numër të të punësuarve nga tre deri në nëntë kanë shkallë më të lartë të vendeve të lira të punës, e cila 1.93 për qind, gjegjësisht kanë 1795 vende të lira të punës. Rajoni i Pella-gonisë ka shkallë më të lartë të vendeve të punës, e cila është 2.05 për qind, por numër më i madh i punëtorëve kërkohen në rajonin e Shkupit 3.581. Numër më të madh të vendeve të lira të punës, gjegjësisht 2794, ka në grupin e pestë të profesioneve - punëtorë në veprimtaritë shërbyese dhe shitje.

Nxënësit e Novosellës ende pa shkollë

Tetovë, 3 shtator - Nxënësit e shkollës fillore të fshatit Novosellë të Komunës së Bogovinës, nuk e shijuan orën e parë mësimore në vitin e ri shkollor, për shkak të mungesës së objektit shkollor, i cili u dogj tërësisht nga zjarri në muajin tetor të vitit të kaluar. Këshilli i Prindërve me anë të një proteste simbolike, kanë alarmuar institucionet kompetente që të ndërmarrin masa urgjente që nxënësit sa më parë të fillojnë me

mësimin. Drejtori i kësaj shkolle fillore periferike, thotë se po bëhen përpjekje që nxënësve tu sigurohem mundësi alternative për fillimin e procesit mësimor. Nga Komuna e Bogovinës thonë që i kanë ndërmarrë të gjitha aktivitetet në kuadër të kompetencave të tyre. Ministri i Arsimit, Arbër Ademi, ndërkohë është shprehur se aktivitetet për ndërtimin e kësaj shkolle tashmë kanë filluar, duke respektuar dispo-

zitat ligjore rreth furnizimeve publike. Nxënësit e fshatit Novosellë të Komunës së Bogovinës për shkak të mungesës së objektit shkollor, kanë mësuar nëpër klasa të improvizuara tek zyrat e Bashkësisë Lokale të fshatit Novosellë të Komunës së Bogovinës, ndërsa është shfrytëzuar edhe xhamia e fshatit. Në ndërkohë, në Tetovë mësimi ka filluar normalisht në të gjitha shkollat. Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, ka



vizituar gjimnazin “Kiril Pejčinović” në Tetovë për të uruar nxënësit dhe mësimdhënësit për vitin e ri shkollor 2018/19. Me këtë rast, ajo ka uruar

dhe përgëzuar drejtorët e shkollave për të gjitha punët që janë realizuar në periudhën e verës me qëllim që të ketë një vit sa më të mbarë. (U.H)



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Në bazë të nenin 108 të Ligjit për arsimin e lartë (Fletorja zyrtare e R. së Maqedonisë, numër 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/11, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16) dhe nenit 5, paragrafi 1, pika 5, nenit 25, paragrafi 1, pika 6 dhe nenit 51 të Statutit, Universiteti i Evropës Juglindore, në mbledhjen e mbajtur më 10. 04. 2018 miratoi këtë:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVENË AFATIN E DYTË NË UNIVERSITETIN E EVROPËS JUGLINDORE PËR VITIN AKADEMIK 2018/2019

I CIKLI I PARË I STUDIMEVE

I.1 STUDIME TË RREGULLTA - TREVJEÇARE DHE KATËRVJEÇARE

Numri i studentëve në studimet e rregullta në vitin akademik 2018/2019 është si vijon:

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	GJUHA				ÇMIMI PËR SEMESTËR		
		SQI	MKD	ENG	DEU	ÇMIMI I PLOTË 100%	ÇMIMI ME NOTË MESATARE 4.5-4.99 (70%)	ÇMIMI ME NOTË MESATARE 5.0 (50%)
FAKULTETI I DREJTËSISË								
Studime të drejtësisë	TE	80	20			650 €	455 €	325 €
	SK	40	20			650 €	455 €	325 €
Studime të drejtësisë (1)	TE					1,000 €		
Kriminalistikë dhe siguri	TE	40				650 €	455 €	325 €
FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË								
Biznes dhe ekonomi								
Menaxhment dhe marketing	TE	100	15			900 €	630 €	450 €
Financa dhe kontabilitet								
Ekonomi								
Menaxhment dhe marketing	SK	60	15			900 €	630 €	450 €
Financa dhe kontabilitet								
Ekonomi								
Biznes dhe ekonomiks (2)	TE/SK			20		1,000 €	700 €	500 €
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE								
Menaxhmenti publik dhe administrata								
Menaxhmenti publik dhe politikat publike	TE	60	30			650 €	455 €	325 €
Menaxhmenti i organizatave joqeveritare								
Menaxhmenti publik dhe politikat publike	SK	50	20			650 €	455 €	325 €
Menaxhmenti i organizatave joqeveritare								
Shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare								
Shkencat politike	TE	40	20			650 €	455 €	325 €
Marrëdhëniet ndërkombëtare								
Shkencat politike	SK	30	20	20		650 €	455 €	325 €
Marrëdhëniet ndërkombëtare								
FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE								
Shkenca kompjuterike								
	TE	80	20			900 €	630 €	450 €
	SK	25				900 €	630 €	450 €
	TE			30		1,000 €	700 €	500 €
Informatikë biznesi	TE		20			1,000 €	700 €	500 €
	SK			20		1,000 €	700 €	500 €
FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT								
Gjuhë dhe letërsi angleze								
	TE			60		650 €	455 €	325 €
	SK			30		650 €	455 €	325 €
Gjuhë dhe letërsi gjermane	TE				30	650 €	455 €	325 €
Gjuhë, kulturë dhe letërsi shqipe	TE	25				650 €	455 €	325 €
Komunikimi ndërkombëtar	TE	25				650 €	455 €	325 €
	SK	20	20			650 €	455 €	325 €

I.2 STUDIME ME KORRESPONDENCË - TREVJEÇARE DHE KATËRVJEÇARE

Numri i studentëve në studimet me korrespondencë në vitin akademik 2018/2019 është si vijon:

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	ÇMIMI PËR SEMESTËR
FAKULTETI I DREJTËSISË		
Studime të drejtësisë	TE/SK	650 €
FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË		
Biznes dhe ekonomi	TE/SK	900 €
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE		
Menaxhmenti publik dhe administrata		
Menaxhmenti publik dhe politikat publike	TE/SK	650 €
Menaxhmenti i organizatave		
Shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare		
Shkencat politike	TE/SK	650 €
Marrëdhëniet ndërkombëtare		
FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE		
Shkenca kompjuterike	TE/SK	900 €
FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT		
Gjuhë dhe letërsi angleze	TE/SK	650 €
Komunikimi ndërkombëtar	TE/SK	650 €

AFATET PËR PARAQITJE

Kandidatët e interesuar mund të paraqiten duke filluar nga data **3 shtator 2018** deri në datën **28 shtator 2018**.

II CIKLI I DYTË I STUDIMEVE

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	NUM(*)	GJUHA	ÇMIMI PËR SEMESTËR (**)
FAKULTETI I DREJTËSISË				
E drejta penale (1)	TE	35	SQ/MK	650 €
E drejta civile (1)	TE/SK	35	SQ/MK	650 €
Studime të sigurisë (1)	TE/SK	20	SQ/MK	650 €
E drejta kushtetuese dhe administrative (1)	TE/SK	20	SQ/MK	650 €
E drejta ndërkombëtare (2)	SK	20	EN	650 €

FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	NUM(*)	GJUHA	ÇMIMI PËR SEMESTËR
Financa dhe kontabilitet	TE	30	SQ/MK	650 €
Financa dhe kontabilitet	SK	15	SQ/MK	650 €
Menaxhment	TE	20	SQ/MK	650 €
Menaxhment	SK	15	SQ/MK/EN	650 €
Marketing	TE	15	SQ/MK	650 €
Marketing	SK	15	SQ/MK	650 €
Administrim biznesi (MBA)	TE/SK	20	EN	750 €

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	NUM(*)	GJUHA	ÇMIMI PËR SEMESTËR
Administrim publik	TE	25	SQ/MK	650 €
Shkenca politike	TE	20	SQ/MK	650 €
Diplomaci	SK	20	SQ/MK	650 €

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	NUM(*)	GJUHA	ÇMIMI PËR SEMESTËR
Shkenca kompjuterike (3)				
Inxhinieria e të dhënave	TE	40	EN	650 €
Sistemet ueb dhe mobile				
Inxhinieria softuerike				
Sistemet e informacionit				
Informatikë biznesi	SK	25	EN	650 €

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	NUM(*)	GJUHA	ÇMIMI PËR SEMESTËR
Mësimdhënia e gjuhës angleze	TE	50	EN	650 €
Studime gjermane	TE	20	DU	650 €
Studime albanologjike	TE	20	SQ	650 €
Menaxhim dhe udhëheqje në arsim	TE	20	SQ/MK	650 €
Komunikimi ndërkombëtar	SK	20	SQ/MK	650 €

II.1 STUDIME NJËVJEÇARE - 60 ECTS (MODELI: 4+1)

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	NUM(*)	GJUHA	ÇMIMI PËR SEMESTËR (**)
FAKULTETI I DREJTËSISË				
E drejta penale	TE/SK	10	SQ/MK	650 €
E drejta civile	TE/SK	10	SQ/MK	650 €
FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË				
Financa	TE/SK	15	SQ/MK	650 €
Menaxhment	TE/SK	15	SQ/MK	650 €
Marketing	TE/SK	15	SQ/MK	650 €
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE				
Administrim publik				
	TE/SK	30	SQ/MK	650 €
Diplomaci				
	TE	30	SQ/MK	650 €
FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE				
Shkenca kompjuterike - Zhvillimi i softuerit dhe aplikacioneve				
	TE	20	EN	650 €
Informatikë biznesi	SK	15	EN	650 €
FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT				
Mësimdhënia e gjuhës angleze				
	TE	20	EN	650 €
Studime gjermane				
	TE	15	DU	650 €
Gjuhë dhe letërsi shqipe				
	TE	15	SQ	650 €
Menaxhim dhe udhëheqje në arsim				
	TE	15	SQ	650 €
Komunikimi ndërkombëtar	SK	15	SQ/MK	650 €

II.2 STUDIME PROFESIONALE TË SPECIALIZUARA (NJËVJEÇARE - 60 ECTS)

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	NUM	GJUHA	ÇMIMI PËR SEMESTËR
FAKULTETI I DREJTËSISË				
Krimi kompjuterik (4)	TE/SK	15	SQ/MK	900 €
FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË (5)				
Menaxhim profesional me logjistikë dhe zinxhir furnizimi	TE/SK	15	SQ/MK	900 €
Menaxhim profesional i shitjes	TE/SK	15	SQ/MK	900 €

AFATET PËR PARAQITJE

Afati i aplikimit për kandidatët është nga data **14 maj 2018** deri në datën **15 shtator 2018**.

III CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

III.1 SHKOLLA E DOKTORATËS

PROGRAMET STUDIMORE	NUM(*)	GJUHA	ÇMIMI PËR SEMESTËR
FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË			
Ekonomi	15	SQ/MK	1,000 €
Administrim biznesi			
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE			
Shkenca politike	12	SQ/MK	1,000 €
Qeverisja dhe administrata publike			
FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE			
Shkenca kompjuterike	5+5*	EN	1,000 €

AFATET PËR PARAQITJE

Afati i aplikimit për kandidatët është nga data **14 maj 2018** deri në datën **15 shtator 2018**.

Të gjitha detajet e Konkursit në: www.seeu.edu.mk



MINISTRIA E MBROJTJES
REPUBLIKA E MAQEDONISË

Sipas nenit 39 nga Ligji për Shfrytëzim dhe Disponim me Pronat Shtetërore dhe Pronat e Komunave (Gazeta Zyrtare e RM nr. 78/15, 106/15 dhe 153/15, 190/16 dhe 21/18) dhe Vendimeve për Dhënie me Qira të Pronave të Patundshme: nr. 44-2980/1, 44-2982/1, 44-2985/1, nga data 20.03.2018 dhe 44-3946/1 nga data 02.05.2018 („Gazeta Zyrtare e RM nr. 53 dhe 84/18), Vendimit të Ministres së Mbrojtjes nr. 02-5215/1 nga 31.08.2018, Komisioni për Pasuri të Patundshme dhe Pasuri të Tundshme i Ministrisë së Mbrojtjes, shpall

THIRRJE nr. 01/2018-2

Ankand i dyte për dhënie me qira të pronave të patundshme përmes ankandit publik - hapësira afariste përmes ofertave publike elektronike

1. Lëndë e shpalljes janë dhënia me qira e pronave të patundshme – hapësira afariste të përcaktuara me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për dhënien me qira të pronave të patundshme nr. 44-2980/1, 44-2982/1, 44-2985/1 nga data 20.03.2018 dhe 44-3946/1 nga data 02.05.2018 („Gazeta Zyrtare e RM nr. 53 dhe 84/18) dhe Vendimi i Ministres së Mbrojtjes nr. 02-5215/1 nga 31.08.2018, si vijon:

Nr. Ren.	Të dhënat e kadastrës mbi pasurinë e patundshme	Sipërfaqja m ²	Vlera e parashikuar në denarë	Qiraja fillestare mujore në denarë pa TVSH	Afati i qirasë
1.	rr. A. Dimovski në Shkup, numri i ndërtesës 3, hyrja 1, kati PR, numri 1, qëllimi i një pjese të veçantë/të përbashkët të ndërtesës HA, si më poshtë: HA1, HA 2, 01 dhe WC1, me sipërfaqe të brendshme 114m2, nr. 747 / 1, KK Kisela Voda 2, LP nr. 105974 CM Kisella Voda 2, pronë e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes	114	4.589.345	22.947	7 vjet
2.	rr. Josif Josifovski nr. 1 në Manastir, numri i ndërtesës 1, hyrja 1, kati i PR, qëllimi i një pjese të veçantë / të përbashkët të ndërtesës HA me sipërfaqe prej 128m2, LP 8968/3, PK nr. 30639 KK Manastir 3, pronë e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes	128	8.733.492	43.667	7 vjet
3.	rr. Partizanska nr. 96 / 98 në Manastir Nr. 1, Hyrja 4, Kati PR, me sipërfaqe 104m2, PK Nr. 14618, KK Manastir 3, LP nr. 91955, pronë e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes	104	5.495.640	27.490	7 vjet
4.	Shtëpia e ARM-së në Tetovë në rrugën "Boris Kidrich" - në PK nr. 2077, KK Tetovë 1, e regjistruar në Listën e Pronave nr. 6335, prone e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes me një sipërfaqe totale prej 896 m2,	896	83.566.077	417.830	7 vjet

2. Procedura për dhënien me qira të pronave të paluajtshme nga pika 1 e këtij vendimi, kryhet nga Komisioni për Pasuritë e Patundshme dhe Pasuritë e Tundshme të Ministrisë së Mbrojtjes, të themeluar me vendimin nr. 02-768 / 3 të datës 01.03.2018 me përmes ofertimit publik elektronik.

3. Kushtet e veçanta për pjesëmarrje në ofertimin elektronik publik dhe teksti integral i thirrjes për qiradhënie të pasurive të patundshme – hapësira afariste mund të gjenden në faqen e internetit: e-aukci.finance.gov.mk dhe në ueb faqen e Ministrisë së Mbrojtjes www.morm.gov.mk

Komisioni për Pasuri të Patundshme
dhe Pasuri të Tundshme i
Ministrisë së Mbrojtjes

Në bazë të neneve 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për sigurim shëndetësorë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pajtuemërinë për punësim nga Ministria e financave numër 18-9564/2 të datës 21.08.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02- 574 të datës 03.09.2018 u.d Drejtor i IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar, publikon

SHPALLJE PUBLIKE për punësim

- IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar ka nevojë për punësim të:
 - Doktorë të medicinës specialist i gjinekologjisë dhe akusherisë për kohë të pacaktuar 51(një) kandidatë.
 - Kandidatët duhet të plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor:
 - të jetë shtetas i RM,
 - të jetë i moshës së rritur,
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
 - të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 - Krahas kushteve të përgjithshme nga pika 2 të përcaktuara me ligj kandidatët për:
 - Doktor i diplomuar i medicinës specialist i gjinekologjisë dhe akusherisë duhet të përbush **kushtet e posaçme** në vijim:
 - arsim sipëror të mbaruar (VII/1) ose 240 kredi sipas SETK pranë Fakultetit të mjekësisë
 - Provim për specializim të dhënë
 - Licencë për punë
 - Me dhe pa përvojë pune.
 - Orari javor i punës është 40 orë. Paga fillestare e kandidatit është 32.979,00 denarë.
 - Së bashku me fletëparaqitjen kandidati obligohet që të parashtrijë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt dhe gjuhë të zgjedhur ndërkombëtare të cilin do ta japë kandidati (angleze, gjermane ose frënge) në pajtim me nenin 160 nga Ligji për Sigurim Shëndetësorë për të cilën dedikohet procesi i selektimit
 - Biografi të shkurtë (CV)
 - Diplomë me suksesin mesatar
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës për doktorët e diplomuar të medicinës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për provim të dhënë për specializim, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.
 - Afati për paraqitje në shpalljen publike është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni jo në kohë, të pakompletuar dhe pa rregulluar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur nga pika 3 të cilët i përbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 parag.2 të Ligjit për sigurim shëndetësor.
 - Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të parashtrihen deri në IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar rr. Shishka nr. 35 përmes postës ose në arkivin e IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar

Në bazë të neneve 156, 157, 158, 159 dhe 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-7491/2 të datës 10.07.2018, Vendimin për punësim në shpalljen publike nr. 02-640/1 të datës 03.09.2018 nga UD Drejtori, D-r. Predrag Bozhicković të IPSH Institutit për sëmundje të mushkërive dhe TBC – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE Për punësim të punëtorëve shëndetësor

- IPSH Institutit për sëmundje të mushkërive dhe TBC Shkup ka nevojë për punësim të:
 - 2 (dy) mjekë në specializim për mjekësi interne (doktorë të medicinës) për kohë të pacaktuar dhe
 - 3 (tre) motra medicinale për kohë të pacaktuar
- Kandidatët duhet të plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Të jetë i moshës së rritur,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
 - Të mos jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga pika 2 me ligj kandidatët për **mjekë në specializim për mjekësi interne (doktorë të medicinës)** duhet të përbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim:
 - Vendim nga Dekanati i Fakultetit të medicinës për miratim të specializimit për medicinë interne
 - Arsim sipëror të mbaruar (VII/1) – Fakulteti i mjekësisë me 240 SETK – Fakulteti i medicinës,
 - Nostrifikim të diplomës për kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit
 - Provim të dhënë profesional
 - Licencë për punë
 - Me dhe pa përvojë pune
- Orari javor i punës është 40 orë. Paga fillestare e mjekut në specializim për mjekësi interne (doktorë të medicinës) është 29.735,00 denarë.
- Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga pika 2 me ligj kandidatët për **motra medicinale** duhet të përbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim:
 - Arsim të mesëm të mbaruar të medicinës (PMP – shkalla IV)
 - Provim të dhënë profesional
 - Me dhe pa përvojë pune
- Orari i plotë i punës – punë me ndërrime. Neto pagesa fillestare për motër medicinale është 18.509,00 denarë.
- Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët për **vendin e punës (doktorë të medicinës)** obligohen të parashtrijë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
 - Biografi të shkurtë (CV)
 - Diplomë me sukses mesatar
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Diplomë për Fakultet të mjekësisë të mbaruar, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Dëshmi për njohje të një prej tri gjuhëve të huaja (angleze, frënge ose gjermane)
- Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët për **vendin e punës motra medicinale** obligohen të parashtrijë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
 - Biografi të shkurtë (CV)
 - Diplomë me sukses mesatar ose certifikata/dëftesa për arsim të mbaruar me të gjitha vitet, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Afati për paraqitje në shpallje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.
- Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve për doktor të medicinës dhe motër medicinale që i përbushin kushtet në bazë të shpalljes publike, do të realizohet përzgjedhje e kandidatit në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.
- Fletëparaqitja me dokumentacionin e përgjithshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohet në IPSH Institutit për sëmundje të mushkërive dhe TBC Shkup nr. Nëna Terezë nr. 17 – Shkup, përmes postës ose në arkivin e IPSH Institutit për sëmundje të mushkërive dhe TBC Shkup,

Drejtor
UD. Drejtor Dr. Predrag Bozhicković

Shkolla!

Nga

Adelina MARKU



Kjo javë shënohet nga fillimi i vitit të ri shkollor dhe shumë nga angazhimet tona prindore janë të lidhura me preokupimet mbi fëmijët e edukimin e tyre. Nuk do shumë analizë e për të konstatu se kemi mbi një dekadë tuj u mërzi për cilësinë e arsimit këtu tek ne dhe kjo brengosje jona e gjatë fatkeqësisht, ka hy në fazën e limbos dhe ka rrezik që të fiket nga pashpresa se diçka mundet me u ndryshu në këtë drejtim! Nuk është natyra ime as nihilte e as konformiste, biles më vjen rëndë tek shkruaj me këtë dozë shprese të lënduar, ngase po flas me pranim për betejat e humbura të mijat e gjeneratës sime. Pastaj jam në një moshë kur pjekuria më flet se pranimi i realitetit është çlirimi nga shpresa dhe një frikë e re në esencë! Si të çlirohemi nga kjo frikë e re?

Në ndërkohë realiteti tregon se rënia drastike e numrit të të regjistruarve nëpër shkolla fillore, (pothuajse e menjëhershme këto dy tre vitet e fundit), ka bërë që ato të mbyllen. Ishte një lajm ky që e lexova të ketë ndodhur në një fshat të Komunës së Strugës ndërsa më zhyti rëndë në trishtim! Kjo do thotë se edhe një numër i madh i arsimtarëve kanë mbetur pa bukë goje!

Sa kataklizmike mund të duket kjo gjendje? Paj shumë..., s'kam si e zbus me pritje optimistësh ose mohuesish të realitetit dhe as nuk e kam ndërmend të shënjestroj subjekt politik për këtë gjendje, sepse në kuptimin tim - faji është edhe i subjektit politik e qeverive në vazhdimësi por edhe i yni, si votues vartës, jo aktiv! Ndoshta më shumë i yni...; me gjasë fillimisht lejuam trivialitetin- dmth jo mjaftueshëm e peshonim situatën që derogonte cilësinë e arsimit, ndërsa tani jemi në limbo – pra jemi në dimenzionin e një shprese të vakët se gjërat do ndryshojnë disi, pa vepruar e pa u angazhuar vetë. Doemos ky mendim është i dembelit dhe i të papërgjegjshmit, ajo që ne jemi në fakt – si shoqëri! Nuk është gjetje e re të thuhet se gjërat nuk do ndryshojnë pa ndryshuar performansat ekonomike në shtet e para dhe e dyta pa u civilizuar e liberalizuar kuptimi mbi arsimimin modern të fëmijëve tanë! Mos të harojmë se ende rezistohet me etnonacionalizëm primitiv përdorimi zyrtar e i gjithmabrshëm i gjuhës shqipe në shtet...ose mjafton të kujtojmë se sa e mërzitshme dhe absurde njëkohë-

sisht na u duk tema e sivjetshme se a do përdoret gjuha shqipe në Mbrëmjet Strugane ose jo. Padyshim kësaj here biles as edhe nuk treguam një fije mërzie nëse u përdor ose jo...Ja ky quhet stadium: LIMBO! INDIFERENCË! Kësi konstatimesh, bashkë unë e ti I/e nderuar lexues/e mund të bëjmë 24 orë rresht...të dy e dijmë se, nga konstatime njeriu nuk bëhet njeri i plotë, pasi mungon aksioni apo! Ikja nga vendi, sot mbetet të jetë aksioni i vetëm i qytetarit në Maqedoni!

Teza ime është se kjo situatë e "pritjes së ndryshimit!" është e rrezikshme; boshllëqet që janë kriju nga mosmenaxhimi i mirë i sistemit arsimor dhe shtresimi i plotë i korruptcionit material, politik e moral nëpër institucionet arsimore po zëvendësohet nga fenomene radikale e që përhapen masivisht ndër të rinjtë. Këtu do vëmendësia në dy të dukshme sipas mendimit tim, në fenomenin e depresionit tinzar që i ka kapur ata e që gradualisht i radikalizon me shpërthime zhytjesh në përdorim të drogërave të ndryshme por edhe ikjes në dimenzione mistike të interpretimit të fesë, si shpëtim!

Minori /ja sot e i/e riu(ja) përballen me fenomenin e abuzimit me ve-

ten vetë e që vjen si rezultat rrethor do gjykoja! i/e lënë anash nga kujdesi prindor për shkak të depresionit material në familje, në vazhdimësi i/e stigmatizuar për shkak të përkatësisë etnike ose fetare, i/e zhytur në ideologjinë e trashëguar i/e të qenurit dytësor/e për shtetin, i/e rrethuar nga kontekste politike kryesisht të imputuara, i/e vetëdijshëm/e për fenomenin e korruptcionit që në fëmijëri, i/e preokupuar përditshëm me një lloj komunikimi virtual me Tjetrin Të Panjohurin përmes internetit, i/e servisuar me instant dije nëpër institucionet arsimore, shpesh i/e ndodhur para mësimdhënësit partiak ose profesorit universitar që nuk e ka bërë as edhe një kërkim shkencor e ku më të nxejë dije, etj etje...i riu/e reja sot vetëpëll e krijon mekanizma shpëtuese për veten duke ndërtuar Identitet të pranueshëm për veten e në kërkim përkatësie jashtë shoqërisë e normave. Ku përket ai/ajo? Cili është grupi i ri shpëtues? Në hesapin tim janë katër streha minorësh e të rrinjsh sot:

1. Partia si zëvendësim i familjes e shtetit;
2. Feja si zëvendësim i familjes e shtetit;

Identitetet e reja të minorit e të riut sot, pra ai partiak, fetar, abuzues dhe emigrues janë "armiqtë" e shtetit sot e të cilët i ka rreshtuar shteti tuj abuzu me veten, shoqin! Ku është shpëtimi? Lehtë do konstatoja se qëndron tek krijimi i masës vetëkritike fillimisht, pranimi i fajit dhe përpunimi moral e institucional i pendimit, tek liberalizmi kulturor dhe tek rritja ekonomike!



3. Droga e abuzimi seksual - si zëvendësimi familjes e shtetit;

4. Ikja si zëvendësim i familjes dhe shtetit;

Identitetet e reja të minorit e të riut sot, pra ai partiak, fetar, abuzues dhe emigrues janë "armiqtë" e shtetit sot e të cilët i ka rreshtuar shteti tuj abuzu me veten, shoqin! Ku është shpëtimi? Lehtë do konstatoja se qëndron tek krijimi i masës vetëkritike fillimisht, pranimi i fajit dhe përpunimi moral e institucional i pendimit, tek liberalizmi kulturor dhe tek rritja ekonomike! Padyshim që kjo është e thjeshtë për t'u konstatuar! Por dorën në zemër, e kam shumë të vështirë të prognozohet se sa resurse dhe kapacitete të sinqerta kanë mbetur mes nesh tanimë e që të riun/të renë sot - t'a bëjë konkurent zhvillimi në vend e jashtë tij! Më duhet të mbetem e rezervuar në optimizëm megjithatë dhe kjo në përktim është Hapja e Pandorës së dytë pas referendumit në shtet!

Këtë gjë bashkë e dijmë, e ndjejmë dhe e vuajmë... dhe nuk çlirohemi nga frika megjithatë, sepse... s'dijmë si! Zgjedhëm LIMBON!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 3 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Mitrovica vs. Presheva

Nga
Redi SHEHU



Jo larg, por dhjetë vjet më parë, në një ditë të ftohtë dimri, mijëra vetë mbushnin sheshet e Prishtinës dhe të gjitha qyteteve kosovare, duke festuar të ekzaltuar për shpalljen e pavarësisë së një cope Shqipërie të persekutuar për gati një shekull nën një aparteid serb krejt tipik në llojit e vet. Avulli që dilte nga gojë e shqyera prej gëzimi të atyre turmave njerëzore, jepte përshtypjen e një makinerie gjigante njerëzore prej avulli e vënë në lëvizje nga një shkak i jashtëzakonshëm. Asokohe, sheshet ishin mbushur me ngjyrën kuqezi të flamurit kombëtar shqiptar dhe as që mendohej e as që imagjinohej që pak vite më vonë, një copëz blu, me një hartë të verdhë administrative të Kosovës, do të përbente atë flamurin anemik politik të saj, i cili do të shërbente si alibia e korrektesës dhe ndershmërisë së politikanëve kosovarë në raport me atë që ata fort pëlqejnë ta përmendin: dhuruesit e pavarësisë së Kosovës!

Prej asaj dite të ftohtë, shumë gjëra kanë ndodhur dhe pranvera kosovare, në kuptimin politik, po ngelet gjithmonë e më shumë një stinë me pak lule të çelura. E përmbledhur në pak fjalë, ajo që ka ndodhur me bisedimet apo negociatat që politika kosovare ka bërë në Bruksel me serbët, apo edhe me vetë Bashkimin Evropian, ka qenë të pranuarit me plot gojë të të negociuarit të persekutimit, vuajtjes dhe aparteidit me shkaktarin e saj. Në përgjithësi, zakonisht, bisedimet janë një proces që angazhon dy palë, të cilat negociojnë asetet e veta për të arritur në një marrëveshje dypalëshe. Kosova ka qenë prezente në këto bisedime, duke vënë në tryezë asetet e vetëm që kishte, atë të të qenurit viktimë e padrejtësisë dhe vrasjeve historike ndaj saj. Ky aset, për shkak se gëzon atributet morale të njohura ndërkombëtarisht, është i panegociueshëm. Nuk mundet askush të negociojë mbi gjakun, pronën, territorin apo edhe moralin e një kombi. Këto janë vlera të pacenueshme dhe të panegociueshme nga askush. Gabimi me politikën kosovare ishte pikërisht ky, që lejoi dhe pranoi të vinte në tryezën e pazareve politike ndërkombëtare asetet e panegociueshëm të saj. Që me pranimin e futsotës e deri të marrëveshjet diskriminuese ndaj saj, politika kosovare i ka hequr statusin moral të pacenueshmërisë dhe paprekshmërisë së vlerave të veta morale kombëtare.

Nëse Kosova nuk do të pranonte të ulej në negociata, të cilat preknin sadopak këtë aset, ajo sot do të ishte më e avancuar në bisedime, të cilat do të mbronin më shumë interesin e

saj si shtet i ri dhe modern. Tani, aq bajate janë bërë të luajturit me gjërat e panegociueshme dhe të pacenueshme, sa ajo harta e verdhë e territorit të Kosovës në një sfond blu të flamurit politik kosovar, duket se nuk do ta ketë jetën e gjatë. “E ku është problemi?”, mund të thotë dikush.

Ne jemi akoma në botën e eksperimentit dhe epruvetës politike, ndaj çdo gjë është e lejuar. Pas dhjetë vitesh ekzaltime popullore dhe lëpirje të pështira të elitave politike kosovare, rezultatet të çojnë drejt një pesimizmi, i cili sa vjen e bëhet më progresiv lidhur me atë se çfarë do të ndodhë me Kosovën. Sot, pas dhjetë vitesh, në një hipnozë pavarësie, diskutohet nëse do të ndahet Kosova apo jo. Dikush me një entuziazëm adoleshentësh bërtet se mund të marrim Luginën e Preshevës në këmbim të Mitrovicës së Veriut! Uaaa...! Po paprekshmëria dhe pacenueshmëria? Po statusi moral i të qenurit merit

për të gëzuar atë që të është privuar? Ku vajtën? Kush i harroi? Vjen një pikë dhe gjërat pas shumë absurditetesh kalojnë në statusin e tyre qesharak. Kishte jo pak, por më shumë se dhjetë vite që na thuhej se për të bërë gjënë e natyrshme, bashkimin me Shqipërinë, ishte jo vetëm e perealizueshme, por edhe e pamendueshme. Kjo se na zemërohen aleatët. Sot, pas gjithë kësaj periudhe, përballësh me një mundësi, e cila për çudi duket krejt e lehtë: lëshimi i Mitrovicës së Veriut dhe këmbimi me Luginën e Preshevës. Pra, nëse harta anon nga bashkimi dhe zgjerimi i faktorit gjithëshqiptar, kjo është e pamendueshme, por ama nëse anon nga tkurrja dhe deformimi, kjo na qenka diçka krejt e lehtë.

Në situatën në të cilën ndodhet sot Kosova, është më e lehtë qerimi nga harta i Mitrovicës së Veriut, sesa shtimi me Luginën e Preshevës. Ky është një hesap i lehtë për t'u bërë. Deklaratat e presidentit të Kosovës, z. Thaçi, nuk duket se janë origjinale të vetat, sepse është pak e çuditshme që nga një sjellje politike tërësisht vasaliteti, të kalohet në një deklaratë të tillë pa mendimin dhe aprovimin e partnerëve. Gjithashtu, z. Thaçi duhet të na sqarojë se çfarë do të thotë se nuk do të ketë ndarje të Kosovës, por do të ketë shtim të territorit të saj me Luginën e Preshevës. Nëse me këtë i referohet një dëshirë të paparë serbe për integrim në BE, saqë të jenë në gjendje të na e falin Preshevën, kjo as që nuk futet në kategorinë “arsyetim normal”. Nëse me

Serbia, edhe kur e pati humbur luftën në kulmin e disfatës pati bërë me dije se kurrë nuk do të heqë dorë nga Kosova; imagjino tani se çfarë do të bënte me Luginën e Preshevës. Por, edhe nëse do të ndodhte një shkëmbim i tillë, kjo do të legjitimonte çdo përpjekje shqiptare pastaj për të bashkuar kufirin artificial shtetëror me atë natyral kombëtar dhe kështu, Ballkani do të duhej të kthehej në një qendër gjigante tregtare, ku aktiviteti kryesor i saj do të ishte “real estate” me këmbim pronash



këtë do të na tregojë se do bashkohet me Shqipërinë dhe me Preshevën në të njëjtën kohë, kjo do të ishte një aventurë që Evropa dhe historia moderne e saj na ka mësuar se është në limitet e fantazisë. Atëherë, çfarë do të thotë “nuk do humbim territore, po do marrim Preshevën” dhe këtë me referendum popullor? Çështja e Mitrovicës së Veriut, së pari nuk është “çështje”; së dyti, nuk ka asnjë lidhje paralelizuese me Luginën e Preshevës. Këto janë çështje të ndara. E vetmja gjë që i bashkon është se futen brenda kategorisë “çështje shqiptare”. Nëse duam që të zgjidhim çështjen shqiptare duke sakrifikuar një çështje shqiptare, kjo nuk ka të bëjë me ndonjë zgjidhje, por me pazare tipike historike ndërkombëtare në kuriz tonin.

Gjëra tjetër që të lë me gojëhapur është përshkrimi në tërë këtë histori të Serbisë, e cila me tabaka në dorë është e gatshme të na japë Luginën e Preshevës. Serbia, edhe kur e pati humbur luftën në kulmin e disfatës pati bërë me dije se kurrë nuk do të heqë dorë nga Kosova; imagjino tani se çfarë do të bënte me Luginën e Preshevës. Por, edhe nëse do të ndodhte një shkëmbim i tillë, kjo do të legjitimonte çdo përpjekje shqiptare pastaj për të bashkuar kufirin artificial shtetëror me atë natyral kombëtar dhe kështu, Ballkani do të duhej të kthehej në një qendër gjigante tregtare, ku aktiviteti kryesor i saj do të ishte “real estate” me këmbim pronash. A do të ishte e gatshme BE-ja për një gjë të tillë?

Në situatën në të cilën ndodhet sot Kosova, është më e lehtë qerimi nga harta i Mitrovicës së Veriut, sesa shtimi me Luginën e Preshevës. Ky është një hesap i lehtë për t'u bërë. Deklaratat e presidentit të Kosovës, z. Thaçi, nuk duket se janë origjinale të vetat, sepse është pak e çuditshme që nga një sjellje politike tërësisht vasaliteti, të kalohet në një deklaratë të tillë pa mendimin dhe aprovimin e partnerëve





5 milionë në Turqi, afër 1 milion në Itali: Si janë të shpërndarë shqiptarët në botë?

Rreth 12 milionë me etnitet shqiptar thuhet të ekzistojnë në mbarë globin. Tashmë, ata kanë dy komb-shtete të vogla për të drejtuar, duke qenë shumicë por pjesa dërrmuese e etnisë në fjalë shtrihet në shumë vende të tjera të botës në numra mjaft të mëdhenj. Sipas statistikave të fundit, veç në Kosovë dhe Shqipëri banojnë afërsisht rreth 4,3 milionë shqiptarë. 500 mijë vetë e kanë deklaruar identitetin e tyre etnik si shqiptarë edhe në Turqi por mendohet se atje jetojnë afërsisht 5 milionë të tillë. Në Maqedoni jetojnë rreth 560 mijë duke e bërë grupin e dytë etnik më me rëndësi në atë shtet. Deri në 600 mijë shqiptarë jetojnë dhe punojnë, qoftë në mënyrë të përkohshme ose të padokumentuar, në Greqi. 300 mijë vetë jetojnë në Gjermani ndërsa 200 mijë të tjerë në Zvicër. Veç 5 mijë vetë, sipas statistikave janë shqiptarë në Serbi, ndërkohë që 17 mijë në Kroaci dhe 30 mijë në Mal të Zi. Shqiptarë të shumtë ka edhe në vendet skandinave, me Suedinë që prinë me 54 mijë, e pasuar nga Norvegjia dhe Finlanda me nga 10 mijë dhe Danimarka me 8 mijë e 200. Ndërkohë, afër 200 mijë shqiptarë jetojnë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Italia befason me numrin e madh të shqiptarëve, që thuhet se mbërrin në gati një milion.

FËMIJËRIA E TRISHTUAR E STALINIT ME TË ATIN PIJANEC

Kur Stalini fëmijë e shihte të atin të shtrirë në rrugë të lënë vetëm, ai përpiqej ta ngrinte ta merrte për krahu dhe ta çonte shtëpi. "Ai u bë tip i mbyllur, shpesh rrinte vetëm dhe nuk bashkohej të luante me fëmijët e tjerë. Ai thoshte se dëshironte të mësonte të lexonte", kujtonte e ëma

Stalini i vogël, ka pasur një fëmijëri të trishtuar për shkak të marrëdhënieve të dy prindërve. Babai i tij pijanec e tmerronte. "Biri im Soso ishte një fëmijë shumë i ndjeshëm", tregonte e ëma. "Sapo dëgjonte nga rruga të atin që këndonte, menjëherë turrej drejt meje, duke më kërkuar që të shkonte tek fqinjët dhe priste atje derisa ta zinte gjumi".

I ati ushtronte dhunë ndaj të dyve, Stalinit dhe nënës së tij. Njëherë ai e përplasi Stalinin aq



dhunshëm në dyshe me sa fëmija urinoi gjak për disa ditë. "Rrahjet dhe goditjet që nuk i meritonte, e bënë djalin aq të sertë dhe të pashpirt sa edhe i ati" tregonte një shok i tij i fëmijërisë. Sjellja e të atit do të rrënjoste tek ai më vonë urrejtjen ndaj njerëzve.

Ndërsa e ëma i jepte shumë dashuri i ati e trajtonte si një qen. Stalini u rrit mes sherreve, zënive dhe grushteve, ashpërsisë dhe agresivitetit. Kështu që u bë shumë e vështirë që ai të kontrollohej. Goditja psikike e të atit po ndikonte direkt tek i biri. Psikologët e lidhin kulturën e dhunës në jetën e Stali-

nit pikërisht me fëmijërinë e tij. Stalini besonte tek dhuna si "kosa e shenjtë e historisë" edhe si një mjet menaxhues i domosdoshëm.

Kjo u jepte dorë lakenjve të tij që ti godisnin njerëzit me qëllim që ata mund të kontrolloheshin. Sidoqoftë Stalini e pranonte se ka qarë shumë gjatë fëmijërisë së tmerrshme. Gjatë kohës kur ishte fëmijë familja e tij ndërroi 9 shtëpi ndërsa e ëma përpiqej të ndahej nga i atij. Por ai premtonte se do të ndryshonte dhe ata bashkoheshin sërish. Kur ai nuk po e linte pijen ata u vendosën në shtëpinë e një prifti. E gjithë kjo situatë do të

ndikonte tek i biri. Alkolizimi e bëri atë xheloz patologjik, thashethemet mbi tradhtitë e të shoqes, të cilat i dhanë fund pushtetit të dhënë nga Zoti si një mashkull georgjian si dhe qëndrimi i shumë personave në qytet kundër tij, ndikuan që ai të rrënohej.

Kur Stalini fëmijë e shihte të atin të shtrirë në rrugë të lënë vetëm, ai përpiqej ta ngrinte ta merrte për krahu dhe ta çonte shtëpi. "Ai u bë tip i mbyllur, shpesh rrinte vetëm dhe nuk bashkohej të luante me fëmijët e tjerë. Ai thoshte se dëshironte të mësonte të lexonte", kujtonte e ëma.

Përqindja e fëmijëve me ADHD dyfishohet gjatë 20 viteve të fundit



Numri i fëmijëve të diagnostikuar me çrregullimin e hiperaktivitetit të deficitit të vëmendjes (ADHD) ka arritur më shumë se 10 për qind, një rritje e konsiderueshme gjatë 20 viteve të fundit, tregon një studim. Rritja ishte më e theksuar në grupet e pakicave, duke sugjeruar që qasja më e mirë në sigurimin shëndetësor dhe trajtimin e shëndetit mendor nëpërmjet Aktit të Kujdesit të Kujdesit mund të kishte luajtur ndonjë rol në rritje. Shkalla e diagnozës gjatë asaj periudhe kohore u dyfishua te vajzat, megjithëse ishte ende shumë më e ulët se te djemtë. Por studiuesit thonë se nuk gjetën prova që konfirmojnë ankesa të shpeshta se gjendja është e diagnostifikuar ose diagnostifikuar keq. SHBA ka në mënyrë të konsiderueshme më shumë raste të ADHD-së sesa vendet e tjera të zhvilluara, të cilat hulumtuesit kanë thënë se ka bërë që disa të mendojnë se amerikanët po i rëndojnë fëmijët duke bërë shumë diagnoza.

Tani videot në YouTube mund t'i shikoni më ndryshe



Me opsinin e ri të shërbimit më të madh të videos në botë, mund të kufizoni sa kohë do ta shihni, ndër të tjera. Mjetet e reja të YouTube, të cilat duhet të jenë në dispozicion globalisht deri në fund të kësaj jave, janë shumë të thjeshta. Përbëhet nga një koleksion statistikash për sa kohë keni kaluar duke shikuar videot, duke përfshirë YouTube Music dhe YouTube TV, disa opsione shtesë për t'ju

ndihmuar të përcaktoni cilat njoftime do të merrni nga shërbimi i videos të Google dhe sa shpesh, dhe aftësia për të vendosur kufijtë e shikimit.

Nuk është e qartë nëse videot llogariten gjatë kohës që jeni offline dhe nëse keni kanale të shumta në YouTube nën të njëjtën llogari të Google, do të keni vetëm të dhënat e shikueshme që keni bërë gjatë kohës që jeni në lloga-

rinë tuaj kryesore. Për të marrë statistika në telefonin tuaj celular, thjesht hapni YouTube dhe klikoni në profilin tuaj në këndin e sipërm të djathtë për të hapur menynë e cilësimeve. Aty do të gjeni opsinin "Koha e shikuar". Sa i përket kompjuterëve, duket se Google nuk ka përmirësuar ende ueb faqen e YouTube për të mbështetur një funksion të ri, shkruan Gizmodo.

Gjithçka filloi me xhaxha Frank. Sapo ai bëri një kolonoskopi, mjekët gjetën polipet në të gjithë zorrën e trashë. Duke dyshuar për kancer të zorrës së trashë ose një sëmundje tjetër, mjekët zhvilluan testet e gjakut dhe kuptuan se ai kishte një mutacion të gjenit të tij CDH1, krejt rastësisht

Familja Anderson lufton së bashku kundër një kanceri të rrallë të stomakut: 8 nga 9 të rriturit janë prekur. E fundit që është diagnostikuar me sëmundjen është Lacy, 28 vjeçe, më e reja. Tani familja, banore në Springfield të Illinois në SHBA, është mbledhur rreth pacientes për ta inkurajuar atë në betejën e saj. Neoplazia, kanceri i trashëguar i stomakut, i cili shkaktohet nga Andersonin, është rezultat i një mutacioni gjenetik që gjendet vetëm në 400 familje të tjera në botë.

56 dhe 70 për qind e anëtarëve të familjes me mutacion zhvillojnë kancerin; në familjen e Lacy, ajo ka goditur pothuajse 90 për qind. Zbulimi i këtij "vrasësi" të fshehur në gjene të Anderson u bë kur xhaxhai i Lacy, Frank, u sëmur dhe pastaj vdiq në moshën 63 vjeçare. Zbulimi tragjik megjithatë i ka lejuar anëtarët e tjerë të familjes të nënshtrohen testeve diagnostikuese për të zbuluar sëmundjen në fazat e hershme. Një total prej gjashtë anëtarësh Anderson, përfshirë babanë dhe vëllain e Lacy (Mum Paula nuk ka mutacion), janë jashtë rrezikut, për shkak se i janë nënshtrohur një operacioni për të hequr stomakun e tyre. Lacy, me një tumor në fazë të IV, vendosi të martohej me të dashurin e saj

E GJITHË FAMILJA E PREKUR ME KANCERIN E RRALLË



Adam. Në dhomën e tij të spitalit dhe gjatë trajtimeve të kimioterapisë ajo nuk është kurrë vetëm.

Gjithçka filloi me xhaxha Frank. Sapo ai bëri një kolonoskopi, mjekët gjetën polipet në të gjithë zorrën e trashë. Duke dyshuar për kancer të zorrës së trashë ose një sëmundje tjetër, mjekët zhvilluan testet e gjakut dhe kuptuan se ai kishte një mutacion të gjenit

të tij CDH1, krejt rastësisht. Sapo e kuptuan këtë, mjekët ishin të bindur sa ishte i trashëguar kanceri gastrik (HGDC). Ai u diagnostikua në qershor të vitit të kaluar. Duke qenë se ishte mutacion, dy fëmijët e Frank, Laura dhe Eric u testuan dhe ishin pozitivë. E njëjta histori u përsërit për babanë e Lacy, John, dhe vëllain e saj më të madh, Robert. Ka rreth 120 mutacione që

mund të ndodhin përgjatë gjenit CDH1 dhe secili prej tyre mund të shkaktojë kancerin e rrallë të stomakut. Këto mutacione gjithashtu mund të shkaktojnë kancerin e gjirit dhe të ovaries, por zakonisht tumoret fillojnë në stomak. HGDC merr emrin nga modeli i rritjes së tumorit.

Ajo është shënuar nga një sërë grupesh të vogla të qelizave të kancerit të shpërndara sporadikisht në të gjithë rreshtimin e stomakut. Endoskopitë zakonisht shqyrtojnë pjesën e sipërme të stomakut, nga ku grupet kanceroze nuk janë të dukshme. E shoqëruar me faktin se është e rrallë dhe prandaj nuk është në krye të listës së të dyshuarve të zakonshëm që kërkojnë më shumë mjekë, kjo do të thotë që HGDC shpesh nuk diagnostikohet derisa të jetë në fazat e saj të fundit, kur shkalla e mbijetesës mund të jetë aq e ulët sa 20 për qind. I tillë ishte rasti i xhaxhait të Lacy, Frank, i cili vdiq në maj në moshën 63 vjeçare.



Light Phone, telefoni që ju shpëton nga varësia e smartphone

Ka dalë në shitje prej pak muajsh, ky telefon i krijuar nga një kompani amerikane në New York dhe ka gjetur sukses, pasi deri më tani janë shitur 10 mijë copë. Ideja e cila qëndron pas këtij produkti është që të shpëtojë personat nga nomofobia, një term i futur rishtas dhe që ka të bëjë me frikën se mos mbetemi të shkëputur nga telefonat. Light Phone, është një telefon që ofron minimumin e teknologjisë. Ka një ekran me prekje, ku shfaqet ora dhe nëntë tastet për të formuar numrat e telefonit, dhe që lejojnë maksimumin, krijimin e një agjende prej nëntë personash. Ndizet dhe fiket, bllokohet dhe zhbllkohet, asgjë më shumë... si dikur. Kjo gjeneratë e tre telefonash përgjigjet në mënyrë konkrete ndaj asaj që kërkohet dhe ka si ide, tentativën për të frenuar varësinë ndaj telefonave. Light Phone, reklamohet si një "telefon që të respekton vërtetë", duke lënë të lirë personin që e përdor që të merret me detyrat dhe angazhimet që ka, pa kontrolluar smartphonin çdo moment. Është i këshillueshëm edhe për fëmijët në shkollë, të cilët mund të jenë në kontakt me familjen pa u përhumbur në internet. Ky telefon shitet për një çmim që varion nga 50 deri në 100 dollarë.

Në një shtëpi në Iran konfiskohen 3 mijë akrepa!



Në rezultat i një bastisjeje në një shtëpi në qytetin Meshhed të Iranit konfiskohen 3 mijë akrepa. Ebulfazl Shabani, drejtor i Mbrojtjes së Mjedisit në rajonin Horasan Rezevi ka njoftuar se kanë kryer një bastisje në një shtëpi në qytetin Meshhed me arsyetimin e rritjes së paligjshme të akrepave. Sipas agjencisë së lajmeve Mehr, Shabani ka theksuar se pas bastisjes në shtëpi janë konfiskuar 3 mijë akrepa. Duke bërë të ditur se operacioni është ndërmarrë pas një ndjekjeje një javore, Shabani tha se punonjësit e mbrojtjes së

mjedisit nën shoqërimin e forcave policore pas operacionit kanë njoftuar se personi që mbante në mënyrë të paligjshme akrepa në një shtëpi nuk kishte lejet ligjore nga autoritetet përkatëse. Shabani ka shtuar më tej se rritja e akrepave në një lagje të banueshme përbën rrezik. Po ashtu në lajmin ku rikujtohet se në një operacion të ndërmarrë javën e kaluar në një shtëpi në të njëjtin qytet u konfiskuan 12 mijë akrepa, theksohet se 1 gr nga helmi i akrepit gjen blerës nga 8 deri në 10 mijë dollarë.

I keni qejf akulloret? Mos e hani asnjëherë fundin e kaushit...

Vanilje, çokolatë, lajthi, luleshtrydhe, boronicë, arrë kokosi etj etj, lista mund të vazhdojë edhe më gjatë, pasi kur bëhet fjalë për akulloret, "mekatin" më të ëmbël të verës, por edhe të çdo stine tjetër, mundësitë e zgjedhjes janë të pafundme. Ashtu si edhe dëshira për t'i provuar të gjitha. Nuk është aspak çudi që të mëdhenj e të vegjël, fëmijë e gjyshër, femra dhe meshkuj të biem pre e tyre, edhe kur ata që bëjnë akullore

tentojnë të na joshin me kombinime të çuditshme.

Nëse nuk keni mundësinë të shijoni një akullore ashtu si duhet në pasticeri, ato të gatshmet që ruhen në kushte frigoriferike janë një zgjedhje shumë e mirë. Pavarësisht shijes që ka, ekziston një gjë që na kënaq të gjithëve, pjesa e çokolatës në fund të kaushit.

Mirëpo studiuesit e Universitetit të Utrechtit, Hollandë, sapo kanë zbuluar diçka që do na

thyejë zemrat të gjithëve. Ata këshillojnë në mënyrë kategorike të shmangim ngrënien e fundit të kaushit, pasi përmban acide yndyrore të pangopura, shumë të rrezikshme për shëndetin.

Sipas kimistit Bert Weckhuyssen çokolatata që gjendet në fund të kaushit i nënshtrohet një procesi përpunimi në yndyra të rrezikshme, që ndikojnë në shëndetin e zemrës dhe mirëqenien e përgjithshme.



Gjermania e Franca, të rezervuara për liberalizim

Vendimmarrja për liberalizimin e vizave për Kosovën ka kaluar tashmë në Parlamentin Evropian dhe në Këshillin e Ministrave. Ndërsa sfida kryesore për Kosovën në këtë proces mbetet t'i bindë shtetet e rëndësishme si Gjermania e Franca se e meriton liberalizimin dhe se pas heqjes së regjimit të vizave nuk do të ketë migrim masiv të kosovarëve drejt zonës Schengen. Këto shtete deri tani kanë shfaqur rezerva për këtë çështje. Javën e kaluar Komiteti për Liritë Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE) i Parlamentit Evropian (PE) i ka dhënë mbështetje liberalizimit të vizave për Kosovën. Tani vendimmarrja për këtë çështje kalon në Parlamentin Evropian dhe në Këshillin e Ministrave, ku pritet të jetë sfida kryesore për Kosovës. Ministria e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha dhe njohës të këtyre proceseve thonë se Kosovës i mbetet që në muajt në vijim të llojë për të marrë mbështetjen e shteteve të rëndësishme si Gjermania, Franca e Holanda. Përveç kësaj, ata thonë se duhet të shprehet se nuk do të ndodhë ndonjë skandal në qeverisjen aktuale që do të ndikonte në qëndrimin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Kemi përkrahjen e serbëve të Malit të Zi në këto momente të vështira

Drejtues të Listës Serbe kanë takuar të dielën përfaqësuesit politikë të serbëve në Mal të Zi. Me këtë rast, kreu i Listës Serbe ka thënë se serbët e Kosovës morën mbështetje të fuqishme. "Sot kemi pasur mundësi dhe nder që në Mitrovicën e Veriut, të mirëpresim vëllezërit tanë, të cilët janë përfaqësues politikë të serbëve që jetojnë në Mal të Zi. Posaçërisht na vjen mirë që nga këta kemi marrë përkrahje të fuqishme në këto momente të vështira dhe historike", ka deklaruar Rakiq pas takimit.

BARRIKADIMI KUNDËR THAÇIT

Ky barrikadim i partive politike dhe i shoqërisë civile po bëhet para se presidenti Thaçi ta prezantojë në Bruksel idenë për "korrigjimin e kufijve" në takimin e radhës me homologun e tij serb Aleksandër Vuçiq, më 7 shtator

Përfaqësues të partive opozitare, por edhe ata të shoqërisë civile dhe një pjesë e koalicionit qeverisës (AAK dhe Nisma) janë barrikaduar për ta kundërshtuar idenë e presidentit Hashim Thaçi për "korrigjim të kufijve". Të martën pritet që Kuvendi ta mbajë seancën e jashtëzakonshme të thirrur nga subjektet opozitare për ta kundërshtuar "prekjen" e kufijve.

Kurse shoqëria civile për këtë çështje ka thirrur protestë për të mërkurën. Subjektet opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Socialdemokrate, por edhe dy partnerët e koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate janë barrikaduar

kundër idesë së presidentit të Kosovës Hashim Thaçi për korrigjim të kufijve. Këto subjekte politike pritet që në seancën e jashtëzakonshme që mbahet nesër ta votojnë një rezolutë ku shprehet qëndrimi i legjislativit të Kosovës kundër ndryshimit të kufijve. Po ashtu kundër idesë së Thaçit do të protestohet të mërkurën nga shoqëria civile. Ky barrikadim i partive politike dhe i shoqërisë civile po bëhet para se presidenti Thaçi ta prezantojë në Bruksel idenë për "korrigjimin e kufijve" në takimin e radhës me homologun e tij serb Aleksandër Vuçiq, më 7 shtator.

Edhe Partia Social Demokrate ka kohë që e kërkon një seancë të jashtëzakonshme sa i përket bisedimeve Kosovë-Serbi, ka thënë Dardan Sejdiu, shef i Grupit Parlamentar të këtij subjekti partiak. Ai insiston se çështja e dialogut

duhet t'i takojë Kuvendit të Kosovës në të kundërtën shkelet Kushtetuta. "Dialogu duhet t'i kthehet Kuvendit. Ne kemi përkrahur dhe jemi për që të kemi një seancë të jashtëzakonshme". Besoj që rezoluta do të ketë mjaftueshëm votat që të kalojë. Kjo është hap i mirë përpara. Dialogu duhet të kthehet në Kuvend dhe kjo ndodh duke ndërtuar një platformë Kuvendi. Çdo lloj diskutimi me palët e tjera jashtë Kuvendit pa mandat të Kuvendit të Kosovës është në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila është republikë parlamentare".

Në ndërkohë, këshilltari i kryeparlamentarit Kadri Veseli dhe anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, e ka vlerësuar absurde seancën e jashtëzakonshme

parlamentare të thirrur për të martën nga opozita për të diskutuar për dialogun me Serbinë. Në një intervistë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e pafalshme për opozitën që ta shtrojë për debat ndarjen e Kosovës në Kuvend. Sipas tij, subjektet opozitare po e legjitimojnë këtë temë kur kjo çështje nuk është temë e dialogut Kosovë-Serbi. Stavileci ka deklaruar se është e panevojshme që Kuvendi të nxjerrë rezolutë për mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës kur atë e garanton Kushtetuta e Republikës.

Duke folur për idenë e presidentit për korrigjimin e kufirit me Serbinë, përmes të cilit synohet që Lugina e Preshevës t'i bashkohet Kosovës, ai ka thënë se PDK-ja do të ishte e lumtur që nëse në fund të këtij procesi negociator, Lugina do t'i bashkohet Kosovës.

MARRËVESHJA ME SERBINË I SJELL KOSOVËS NJOHJE TË REJA

Zgjidhja më e mirë për çështjen e Kosovës del të jetë një marrëveshje dy palëshe me Serbinë që do të ndihmojë për një vendim të ri, vendet që nuk e kanë njohur shtetësinë e saj ka thënë në një konferencë për media Ministri i Jashtëm i Rumanisë, Teodor Meleskanu. Këto deklarime ai i ka dhënë ndërsa po merrte pjesë në takimin informal Gynich të Ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian. "Ne jemi shumë të inkurajuar nga takimet e fundit midis presidentit Vuçiq dhe

presidentit Thaçi. Besoj se zgjidhja më e mirë është një mirëkuptim dypalësh", tha Meleskanu. Ai shtoi se një marrëveshje mes Kosovës e Serbisë do të ndihmojë shtetet e tjera që nuk e kanë njohur Kosovën "për të marrë një vendim përfundimtar mbi këtë çështje". Më tej ai thekson se Rumania është një mbështetëse e fuqishme e politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe, nga këndvështrimi ynë, Ballkani Perëndimor është një pjesë e rëndësishme e Europës

Këshilltari i Karaxhiqit dënohet me 11 vite burgim

Gjykata në Bosnjë e Hercegovinë ka dënuar me 11 vite burgim Jovan Tintor, këshilltarin special të luftës të liderit politik të serbëve gjatë luftës së Bosnjës mes viteve 1992-1995, Radovan Karaxhiq. Gjykatësja Minka Kreho tha në deklaratën e saj se Tintor, i cili ka qenë kryesues i "Tryezës së Krizës" në Vogoshça të Sarajevës, është shpallur fajtor për përfshirje në sulmet sistematike ndaj popullatës civile jo-serbe në Sarajevë dhe Vogoshça nga muaji prill i vitit 1992,

deri në muajin korrik. Kreho theksoi se ka kryer krime kundër njerëzimit duke u bërë pjesëmarrës në përpjekjet për krim të përbashkët, duke shtuar se kampi i përqendrimit "Bunker" në Vogoshça është formuar me vendim të Tintorit dhe ka qenë në dijeni për torturat që u janë bërë të burgosurve. Kreho citoi edhe dëshminë e një viktime të kampit të përqendrimit "Bunker", e cila "në maj të vitit 1992 është goditur në bark nga Tintor teksa ka qenë në muajin e gjashtë



të shtatëzanisë dhe i është prerë gjoksi me urdhër të tij". Ndryshe, Tintor është arrestuar në shkurt të

vitit 2016 në kufirin midis Bosnjës dhe Serbisë, me urdhër arresti të lëshuar në vitin 1999.



Presidenti francez tregon gjurmët e para të konsumimit. Reformat e tij urrehen, ministri i Ambientit largohet, roja personale e tij rreh të tjerë: Macroni ndodhet nën presion. Kjo e dëmton projektin e tij të Evropës

Butësia politike, me të cilën e trajtuan francezët qeverinë e tyre në muajt e verës ka kaluar, së bashku me verën. Me ashpërsi të freskët kombi ndjek politikën nga Elizeja. Ai që e ndien këtë është para së gjithash Emmanuel Macroni. Periudha verore që për të herë e ëmbël dhe e plogësht dhe herë e hidhur. Presidenti e kaloi njëfarësoj verën e stuhishme në politikën e brendshme. Nisur që nga afera me njërin nga punonjësit e ekipit të sigurimit të tij, Alexandre Benalla. Që ai, një i punësuar i Pallatit Elize ndërmori veprime të dhunshme, pa u përballur me pasojat të forta, kjo i revoltoi francezët. Në fillim Macroni heshti dhe pri-

ti që të kalonte e gjitha, pastaj ndërmori sanksione vetëm kozmetike.

Sipas ekspertit të politikës Jerome Sainte-Marie nga Qendra Kërkimore Polling Vox në Paris, kjo tregon edhe një herë më tepër stilin autoritar të Macronit, gjë që bën që ai të bjerë edhe në sondazhe. Muaji i mjaltit ka kaluar, "shumë zgjedhës e vëzhgojnë Presidentin e tyre me skepticizëm në rritje", thotë Sainte-Marie. Në bazë të një sondazhi të fundit të institutit demoskopik BVA, 59 përqind e francezëve janë të pakënaqur me Presidentin e tyre. Kritika vjen jo vetëm nga kundërshtari. Edhe treçerëku i elektoratit të tij është i pakënaqur: dorë e ashpër në politikën e sindikatave, shkurtime në subvencionin për banesën, shkurtime te punonjësit e hekurudhave; shumë vetëve, të cilët e zgjedhën Macronin 40 vjeçar edhe me shpresa të majta, ai tani u duket tepër liberal, tepër i djathtë.

Që tani edhe Nicolas Hulot, ministri i yllit të Macronit për Ambientin dhe Qendreshmërinë jep dorëheqjen, kjo e dobëson Presidentin, i cili po i bie tani kryq e tërthor Evropës. Emmanuel Macroni ka vizituar tashmë 16 shtete të BE, së fundi Danimarkën dhe Finlandën. Synimi dhe kuptimi i këtij turneu të gjerë në Evropë është për të sa i rëndësishëm, aq edhe i vështirë. Në kohën e duhur para zgjedhjeve për Evropën në

maj 2019, ai do të bëjë për vete elektoratin në të gjithë Evropën. Nga e majta, qendra, te e djathta. Ambicia e tij politike: ndarja e Evropës në një kamp të nacionalistëve dhe të "përparimtarëve". Macroni, i thotë DW analisti Bruno Cautres nga Qendra Kërkimore Cevipof, synon të përçajë para së gjithash të djathtën evropiane. Që të shfaqet në fund, me partinë e tij République En Marche (REM) si "alternativa e vetme për ta zgjedhur".

Ekspertët vërejnë se rezistenca në nivelin evropian po konsolidohet. Krahas me Çekinë dhe Austrinë, kryeministri hungarez Viktor Orban ka kohë që përdor një ton euroskeptik, të ashpër. Që tani edhe Italia, një shtet themelues i BE, kërkon solidaritet me Orbanin, kjo e bën të pranueshëm në sallonet evropiane kryeministrin hungarez. Edhe Suedia liberale pret një zhvendosje të qartë djathtas në zgjedhjet në fillim të shtatorit. Shumë partnerë që mendojnë si ai, Macroni aktualisht nuk ka. Merkelin ai do ta takojë këtë të enjte në Paris. Kancelarja gjermane konsiderohet vërtet partnere e sigurt. Së bashku ata duan të çojnë përpara ide reformuese, si një mbrojtje të përbashkët. Por në fund, janë të bindur disa ekspertë, sukcesi politik i familjeve evropiane në Evropë do të vendoset në çështjen e migrimit.



Tregti pa dollarin amerikan

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, propozoi shqyrtimin e alternativës për tregti me valuta vendase, duke thënë se varësia ndaj dollarit amerikan ka filluar të bëhet pengesë. "Varësia e tregtisë ndërkombëtare ndaj dollarit amerikan ka filluar të bëhet pengesë përballë nesh. Andaj, ne propozojmë të fokusohemi mbi alternativën e bërjes tregti me valutat tona", tha Erdoğan në Samitin e 6-të të Këshillit Turkik në Kirgistan. "Disa vende përpiqen t'i nxjerrin në plan të parë kërcënimet, shtypjet dhe shantazhin, në vend të diplomacisë, dialogut dhe multilateralizmit në zgjidhjen e çështjeve ndërkombëtare. Si pasojë e metodave si kufizimet tregtare, tarifatat doganore dhe sanksionet, marrëveshjet që janë vepër e shumë viteve mund të bëhen të pakuptimta për një çast", tha presidenti turk. Erdoğan theksoi se Turqia do të vazhdojë të mbrojë dialogun, diplomacinë dhe drejtësinë në solidaritet me komunitetin ndërkombëtar. Ai shtoi se bashkëpunimi dhe solidariteti mes shteteve turkike do të kontribuojë në funksionimin e drejtë të sistemit ndërkombëtar, shtoi Erdoğan. Presidenti i Turqisë theksoi Ballkanin, Afrikën e Veriut dhe Palestinën nuk i konsiderojnë jashtë botës turkike. "Derisa çështja palestineze të mos arrijë një zgjidhje të drejtë dhe të përhershme, as vendosja e sigurisë dhe stabilitetit ndërkombëtar nuk do të jetë e mundur", deklaroi Erdoğan, duke riafirmuar zotimin për të vazhduar përpjekjet për paqe dhe drejtësi në rajonet si Palestina, Siria, Iraku, Jemeni dhe Afganistani. Samiti mbahet në mikëpritje të presidentit të Kirgistanit Sooronbay Jeenbekov në Qendrën Kulturore Rukh Ordo. Krahas presidentëve të Turqisë, Azerbajxhanit, Kazakistanit dhe Uzbekistanit, edhe Hungaria si shtet vëzhgues është përfaqësuar nga kryeministri i saj.



Kundër një referendum të dytë për Brexit

Sa më shumë që afrohet dalja nga BE, aq më shumë spekulohet në Britaninë e Madhe për një referendum të dytë. Kryeministrja Theresa May u ndje e detyruar të bëjë një sqarim. Negociatori i BE, Barnier shton presionin

gjithën edhe një herë nga e para do të ishte mashtrim në stil të gjerë për demokracinë tonë", shkroi May në një artikull e ftuar në gazetën "Sunday Telegraph". Së fundi, edhe deputetë nga partia konservatore e Mayt janë shprehur për nevojën e mbajtjes së një referendum të dytë, po ta refuzojë parlamenti britanik rezultatin e negociatave të daljes nga BE me Brukselin. Një grup poli-

tikanësh proevropianë përpiqet që ta vërë këtë në rend të ditës në kongresin e partisë laburiste në fund të shtatorit.

Deri tani, kërret e dy partive të mëdha e refuzojnë në parim mbajtjen e një referendum të ri. Sondazhet megjithatë tregojnë se është e mundur që në popull të krijohet një shumicë mbështetëse për mbajtjen e një referendum të dytë. Deri në këtë moment nuk

është as e qartë, nëse deri në daljen në BE në 29 mars 2019 do të arrihet një marrëveshje, për të cilën të mund të votohet. Negociatat ecin me vështirësi. Me këtë shtohen gjasat që Britania e Madhe të dalë pa marrëveshje nga BE - gjë që do të kishte pasojat të rënda.

Por një shtyrje e datës së daljes së Britanisë së Madhe nga BE nuk vjen në diskutim për kryenegocia-

torin e BE Michel Barnier. "Neve nuk na duhet më tepër kohë. Ajo për të cilën kemi nevojë janë vendimet politike", i thotë ish-ministri i Jashtëm francez dhe ish-Komisar i BE gazetës "Frankfurter Allgemeine Sonntagszeitung". Bisedimet, rithekson ai, duhet të kenë përfunduar deri në mes të nëntorit. Qeveria britanike kërkon për vendin e saj një marrëveshje të posaçme me akses të privilegjuar në tregun e brendshëm të BE për degë të veçanta. Për Brukselin vjen në diskutim vetëm një marrëveshje e tipit të zakonshëm të tregtisë së lirë.

Në fazën përfundimtare të negociatave të anëtarësimit me BE, kryeministrja britanike Theresa May i kundërshtoi në mënyrë të prerë kërkesat në vendin e saj për një referendum të dytë për Brexitin. "Që ta shtrosh këtë pyetje të

“Mesalina ishte një vajzë e bukur, ngjallë dhe me lëvizje të shpejta, sy të zinj, flokë të zinj dhe kaçurrelë. Kishte një buzëqeshje misterioze që më çmendti”. Por kur një 50 vjeçar, jo shumë inteligjent dhe jo shumë i pashëm dashurohet pas një vajze shumë inteligjente dhe tërheqëse me moshë të njomë, perspektivat nuk janë shumë të mira

I ndante një dekadë. Valeria Mesalina lindi në vitin 25 pas krishit dhe Estatilia Mesalina në 35. Të dyja ishin perandoresha të Romës. Valeria sipas historianëve ishte e bukur, Estatilia po sipas të njëjtave burime ishte më pak tërheqëse nga gratë e Neronit. Valeria jetoi 23 vite, Estatilia 33. Valeria Mesalina dhe familja e saj ishin të afërmit e varfër, dega e rënë e klanit Julia. Pa prikë, kusht për të tërhequr një mashkull me peshë dhe me pasuri, nuk pati zgjidhje tjetër veçse të martohej me Claudio-n, xhaxhain e të çmendurit dhe mizorit Kaligula. Ajo ishte 16, ai 52 dhe me dy martesë dhe dy divorce pas shpine. Një zotëri i pasur, plak me një figurë groteske, i çalë, belbëzonte dhe që gabimisht e merrnin për idiot. Ishte një sovran dhe strateg ushtarak shumë i dashur nga populli. Claudio i dashurohet pas saj e përshkruan kështu: “Mesalina ishte një vajzë e bukur, ngjallë dhe me lëvizje të shpejta, sy të zinj, flokë të zinj dhe kaçurrelë. Kishte një buzëqeshje misterioze që më çmendti”. Por kur një 50 vjeçar, jo shumë inteligjent dhe jo shumë i pashëm dashurohet pas një vajze shumë inteligjente dhe tërheqëse me moshë të njomë, perspektivat nuk janë shumë të mira. Dasma në vitin 40 ishte një festë e gjatë dhe e kushtueshme.

Patën një vajzë, Oktavia që më pas do të ishte një nga gratë e Neronit dhe një djalë, Britanikun. Një jetë në dukje normale që shumë shpejt do të shfaqte fytyrën e vërtetë, sepse tek Mesalina flinte një mostër. Një grua ambicioze, e pamëshirshme që e shndërroi Claudio-n në një kukull dhe e detyroi të vendoste miqtë dhe dashnorët në poste të larta të qeverisë. Me vrasjen e Kaligulës në vitin 41 Claudio bëhet perandor dhe Valeria perandoreshë. I gjithë pushteti në duart e saj. Ndërsa Claudio në krye të legjioneve pushtonte Britaninë, ajo vishte rrobën e pangopshmërisë. Junio Juvelan në një nga satirat e tij e përshkruan kështu: “Kur i shoqi flinte kjo prostitutë perandorake dilte nga shtëpia natën dhe e shoqëruar nga një skl-

HISTORIA E DY PERANDORESHAVE ROMAKE

KRIME, PROSTITUCION, LAKMI DHE BASHKËPUNIM ME TË KEQEN



lave fshihte flokët e zinj nën një paruke bjonde dhe i drejtohej një prej bordellove, ku kishte rezervuar një dhomë dhe mernte pozicionin e vet nudo me emrin Lysiscia”. Dëshmitë dhe thashethemet flisnin se shkonte me shërbëtorë, ushtarë, gladiatorë, fisnikë etj.

Si dhe me Palas, administratorin e korruptuar të thesarit që hodhi mbi të një pasuri të tërë. Mes dashnorëve të saj u shfaq Tito, 15 vjeçar me një etje seksuale të madhe (sipas kronikave). Një marrëdhënie kaq e zjarrtë sa edhe skandaloze, sepse adoleshenti ia rrëfeu gjithë Romës. Mesalina me ndihmën e një mijeje, Locusta-s e helmoi. Historiani Suetonio referon se i pëlqenin aventurat në bordello në lagjen Suburra, i pëlqente kamzhiku, seksi i fortë dhe fitonte si një prostitutë luksi. Legjenda thotë se natën e dasmës, ndërsa Claudio flinte fjete me një sklall që kujdesej për kopshtin dhe se një ditë sfidoi Escila-n, kurtizanen romake më të famshme në një garë



seksi; kush nga ato do të flinte me më shumë meshkuj në një afat kohor të caktuar dhe ajo fitoi. Escila u dorëzua pas 25 burrave. Por fundi po i afrohej.

Në vitin 48 Mesalina u dashuroi pas konsullit Cayo Silio, e detyroi të ndahej nga e shoqja dhe u martua me të, ndërsa Claudio ishte në Ostia dhe festoi me një banquet që ftoi konsujt, senatorët



dhe parinë e vendit që zgjati një ditë. Nga ana tjetër po thurej një plan për të eliminuar Claudio-n dhe për të vendosur si perandor burrin e ri, por Claudio i informuar për bigaminë nga Narçizi, një sklall i liruar, u nis nga Ostia për në Romë. Vrau Cayo Silio-n dhe e dënoi Mesalinën me vdekje. E ekzekutoi Narçizi me shpatën e një centuroni në kopshtet e Luculo-s,

një vend që ajo e donte. Claudio vdiq në 13 tetor të vitit 54 i helmuar nga kërpudha të vendosura në një nga pjatat e tij të preferuara. Vrasësjë ishte Agripina, nëna e Neronit.

Mesalina tjetër ishte gruaja e tretë e Neronit (66-68), nga një familje patricësh, nuk ishte shumë e njohur për romakët. Pothuajse e parëndësishme. Supozohet se ishte vajza e Tito Estatilio Tauro, gjeneralit triumfues dhe dy herë konsull. Nuk vrau askënd, nuk ka regjistra për këtë, por ishte bashkëpunëtore e perandorit të çmendur që për t'u martuar me të shtyu të shoqin, konsullin Vestinio Atico drejt vetëvrasjes. Klani Estatilia ishte një klan kult dhe ndiqte një sekt elitar neopitagorik që kryente rite në tunelet e nëndheshme. Ceremoni që shumëkush i mori për magji. Sipas historianit dhe konsullit Tacito, Neroni ishte dashnor i Estatilia-s para se ajo të martohej me Atico-n, ndërsa ai vetë ishte i martuar me Popean.

Ka dyshime për këtë; ishte e bukur apo e shëmtuar? Nga historianë të tjerë thuhet se ishte më pak tërheqëse nga të gjitha gratë e Neronit. Neroni ishte mik i madh i Atico-s, por kjo marrëdhënie u prish kur Atico filloi të tallej me Neronin në publik, në festa. Miqësia u kthye në urrejtje.

Neroni e akuzoi për konspiracion dhe urdhëroi vdekjen, ndërsa Estatilia luante rolin e një zonje të madhe, një dame që përmbushte të gjitha detyrat dhe që nuk u provua kurrë, nëse kishte intriguar apo kishte marrë pjesë në konspiracione kundër të shoqit, megjithatë ajo nuk mund të injoronte “krimet” e tij.

E gjithë Roma e dinte se kishte helmuar Britanikun, gjysëmveëllain e saj, që vuri të vriste Claudia Octavia-n gruan e parë të Neronit, 22 vjeç duke e akuzuar për tradhëti. Që vrau me shkelma gruan e tij të dytë shtatzanë, Popea Sabina. Kishte helmuar tutorin e saj të vjetër, ushtarakun Sexto Afranio Burro dhe se në verën e vitit 64, ndërsa një e treta e qytetit digjej nga flakët për 6 ditë me radhë këndoi dhe luajti në lirë në vilën e saj. Zjarri filloi të lagjet e varfra dhe gjithmonë është dyshuar, nëse nxitësi ka qenë Neroni i fiksuar për ta shndërruar këto fole të mjera në një sektor luksi, por Estatilia ishte gjithmonë e heshtur, edhe vite pas vdekjes së tirit. Një formë e pa-diskutueshme e fajit.

(bota.al)



Virginia Hall ishte përshkruar nga Gestapo si "spiunia më e rrezikshme e SHBA-ve", duke e konsideruar rrezikun më të madh për Rajhun e Tretë



Edhe pse nuk e kishte një këmbë, asnjë spiun tjetër nuk aftësinë e saj ka në kapjen, zbulimin dhe mashtrimin e nazistëve. Virginia Halla ka lindur më 6 prill të vitit 1906 në Baltimore, në një familje të pasur fermerësh, transmeton Telegrafi. Ishte studente e jashtëzakonshme, kryeredaktore e revistës së shkollës dhe kapitene e ekipit të hokejit. Bashkëmoshtarët e mbajnë në mend si një "vajzë unike".


Shkollimin e kishte vazhduar në Evropë ku kishte diplomuar në fakultetin ekonomik dhe të drejtën ndërkombëtare, që i ndihmoi t'i mësojë gjuhët frënge, italiane dhe gjermane. U punësua në ambasadën amerikane, ku disa muaj më vonë aksidentalisht kishte qëlluar veten në këmbë derisa kishte dalur në gjueti. Si pasojë e plagëve të marra, mjekët janë detyruar t'ia amputojnë këmbën në gju. Aty iu shuan ëndrrat për karrierë në diplomaci, pasi që Departamenti i Shtetit kishte rregulla strikte, ku asokohe u ndalonte konkurrimin personave me probleme fizike. Megjithatë, Hall nuk hoqi dorë dhe refuzoi të jep dorëheqje në ambasadë, por filloi të kërkojë një profesion që i ofronte të ardhme më të ndritur. Kur filloi Lufta e Dytë Botërore, pati dëshirë të luftojë për atdheun. Jetoj në Londër dhe u lajmërua tek njësitë speciale, aty mësoi të përdor armët dhe të organizojë aksione. Më pas ushtria britanike e dërgoi Virginian në Francë, të mbledhë të dhëna për operacionet ushtarake gjermane dhe të ndihmojë lëvizjen e Rezistencës.

Në Francë u fut në gusht të vitit 1941, duke u prezantuar si gazetare e New York Post, kurse në nëntor arriti ta formojë ekipin e fshehtë të qytetarëve besnikë francezë që njiheshin me nofkën "Heckler". Kjo lëvizje e Rezistencës ka pasur sukses të madh, ka ndihmuar në organizimin e lirit të

KUR GJERMANËT E HITLERIT DRIDHESHIN NGA VIRGINIA HALL



ZONJA QË ÇALONTE, SPIUNIA E FRIKSHME AMERIKANE



dhjetëra pilotëve britanikë që kanë luftuar kundër gjermanëve, kanë ofruar informacione forcave aleate dhe kanë futur tinëzsisht në Francë spiunë britanikë.

Por, kur Gjermania pushtoi Francën në nëntor të vitit 1942, ajo iku në Spanjë, megjithatë gjermanët i ishin vënë pas. Aty arritën të kapin shumë agjentë, por jo edhe Virginian që ishte "eksperte" e kamuflimit. Gjermanët filluan të angazhojnë agjentë të dyfishtë që ta eliminojnë apo mbledhin çfarëdo informacioni për këtë grua misterioze, për të cilën nazistët nuk arritën t'ia mësojnë edhe emrin e vërtetë apo kombësinë por që e dinin që çalonte. Por, ishin pikërisht

kushtet e vështira atmosferike që bënë që Virginia të arrestohet për kalim ilegal në malet e Spanjës. Brenda burgut krijoi një lidhje me një të burgosur, e cila pasi u lirua i dërgoi zyrtarëve amerikanë në Barcelonë një mesazh të rëndësishëm. Aty intervenuan që ta lirojnë dhe menjëherë iu bashkua departamentit të spiunazhit amerikan.

Në maj të vitit 1944 u fut sërish në Francë, kësaj radhe më identitet të rrejshëm si francezja Marsel Montanj. Për ta shmangur çfarëdo dyshimi, kishte lyer flokët, mbante protezë dhe për të mos e tërhequr zvarrë këmbën derisa ecte. Aty filloi punën si operatore në radio lidhje, dhe tinëzsisht u dër-



Historia e "një farë" Evita Peron

Ka gra që kanë lënë gjurmë në kohë dhe që kanë ndryshuar historinë, që kanë thyer normat e vendosura nga shoqëria dhe që kanë treguar se janë të afta të bëjnë të njëjtën gjë ose më shumë sesa meshkujt që përpiqeshin t'i fusnin në rolin e bashkëshorteve dhe të nënave. Mari Kyri, Frida Kahlo, Amelia Earhart, Virginia Wolf... Eva Peron. Zonja e parë argjentinase mori një rol të rëndësishëm në jetën politike dhe sociale të kombit të saj duke qenë një mbrojtëse e shtresave të varfra dhe e të drejtave të grave. Fëmijëria e Eva Duartes, vajza e ligjshme e Juan Duartes dhe e Juana Iburguren u karakterizua nga varfëria dhe kontakti me botën rurale. Në moshën 15 vjeçare shkon në Buenos Aires dhe fillon të punojë si aktore, modele dhe folëse në radio. Në vitin 1945 kur kishte fituar pak njohje martohet me kolonelin Juan Domingo Peron dhe një vit më vonë pas zgjedhjeve të së shoqit si president i Argjentinës do të merret krahë nga jeta politike, një nga më aktivet dhe më të rëndësishmet e shek XX. Evita Peron, siç e thërrisnin shtresat e varfra të shoqërisë argjentinase, e përdori pozicionin e saj për të përmirësuar gjendjen e punëtorëve dhe të grave në vendin e Amerikës Jugore.



gonte britanikëve dhe amerikanëve koordinatat e lëvizjes së forcave gjermane. Ajo dhe ekipi i saj kanë arritur të hedhin në erë katër ura, kanë shkatërruar trenat e ushtrisë gjermane, linjat telefonike dhe në total kanë vrarë rreth 150 ushtarë dhe agjentë nazist.

Pas zbarkimit të forcave aleatë në Normandi, ajo dhe agjentët e tjerë u tërhoqën nga shërbimi, dhe kështu përfundoi karriera e saj si spiune gjatë luftës. Megjithatë, vazhdoi të punojë për CIA-n si analiste derisa u pensionua. Në vitin 1982 ndërroi jetë në Maryland.

Në vend që të pranonte poste zyrtare në qeverisje preferoi të aplikonte politikën e saj sociale përmes fondacionit "Eva Peron". Fondet publike me të cilat mbahej u përdorën për ndihma sociale si ndërtime spitalësh dhe shkollash ose në programe mbështetëse për shtresat e varfra. Veç kësaj si ndërmjetëse mes qeverisë dhe sindikatave dhe themeloi partinë peroniste femërore me të cilën mbrojti të drejtat e grave dhe mori votën femërore në vitin 1947. Zonja e parë do të vdiste në 26 korrik 1952 nga kanceri i mitrës duke shënuar kështu edhe rënien e peronizmit që do të shtypej tre vite më vonë nga një grusht shteti me karakter ushtarak. Rëndësia që pati ky personazh femëror për atë periudhë kur gratë ishin të nënshtruara nga meshkujt e shndërroi automatikisht në një figurë të admirueshme dhe të njohur në të gjithë botën. Emri i saj ka kaluar në histori si sinonim i luftës për të drejtat e grave, bindjes dhe stilit femëror.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 169/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Likovës“ për vendet e punës në vijim:

1. UPR 0101V02000 Bashkëpunëtor i lartë për furnizime publike dhe administrim të pasurisë së I realizues(ë)
tundshme në pronësi të komunës, Sekcioni për çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat ekonomike, juridike ose shkencat politike
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- vërtetim për provimin e dhënë për furnizime publike

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
- Rroga neto: 23.232,00 denarë

VËREJTJE:

Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – të. Ai inicohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të nenit 21 paragrafi 3 dhe nenit 22 të Ligjit të punësuarit në sektorin publik, nenit 76 të Ligjit për kulturë të RM dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, INQK "Anton Panov" – Strumicë, publikon

SHPALLJE

Për punësim të pesë (5) personave për kohë të caktuar

1. Për nevojën e lidhjes së marrëdhënies së punës për kohë të caktuar deri më 31.12.2018 në INQK "Anton Panov" – Strumicë në vitin 2018, për vendet e punës në vijim:

1. KUL0405A01002 mjeshtër të dritës (1) realizues;

Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 01-104/1 të datës 04.04.2016 për sistematizim të vendeve të punës në INQK "Anton Panov" – Strumicë;
Kushtet e posaçme, AMP, elektroteknik, gjegejesisht arsim të mesëm trevjeçar
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 18.587 denarë.
Marrëdhënia e punës lidhet me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premtë, ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

2. KUL0401A03007 punëtor tjetër skenik (1) realizues;

Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 01-104/1 të datës 04.04.2016 për sistematizim të vendeve të punës në INQK "Anton Panov" – Strumicë;
Kushtet e posaçme, së paku arsimi fillor
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 14.984 denarë.
Marrëdhënia e punës lidhet me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premtë, ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

3. KUL0401B03001 mirëmbajtës i higjienës (1) realizues;

Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 01-104/1 të datës 04.04.2016 për sistematizim të vendeve të punës në INQK "Anton Panov" – Strumicë;
Kushtet e posaçme, së paku arsimi fillor
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 12.859 denarë.
Marrëdhënia e punës lidhet me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premtë, ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

4. KUL0401A03001 marangoz – mjeshtër skene (1) realizues;

Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 01-104/1 të datës 04.04.2016 për sistematizim të vendeve të punës në INQK "Anton Panov" – Strumicë;
Kushtet e posaçme, së paku arsimi fillor
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 20.795 denarë.
Marrëdhënia e punës lidhet me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premtë, ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

5. KUL0102G01003 referent i pavarur – kontabilist (likuidues – evidentues personal) (1) realizues;

Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 01-104/1 të datës 04.04.2016 për sistematizim të vendeve të punës në INQK "Anton Panov" – Strumicë;
Kushtet e posaçme, PLP (e lartë), arsim të mesëm gjimnaz, arsim të mesëm profesional - drejtimi ekonomik.
Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
Njohje aktive të një prej gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane);
Stazhi i punës minimum 3 vjet.
Neto pagesa fillestare e punëtorit është 18.702 denarë.

Marrëdhënia e punës lidhet me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premtë, ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të parashtrojnë:

- Certifikatë/diplomë për shkallë të mbaruar të arsimit
- Vërtetim/Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë (nën pikën 5).
- Vërtetim/Dëshmi për njohje aktive të gjuhëve (nën pikën 5)
- Vërtetim/Dëshmi për stazh të punës (nën pikën 5)
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se 6 muaj
- Dëshmitë për përbushjen e kushteve duhet të jenë në formë origjinale ose kopje të vërtetuara në noter.
- II. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premtë, ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:30 deri në ora 16:30
- III. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë dëshmi me çka vërtetohet përbushja e kushteve të parapara.
- IV. Shpallja zgjatë (5) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.
- V. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen në arkiv ose përmes postës në adresën në vijim: INQK "Anton Panov" – Strumicë, sheshi "Goce Delçev" pn, 2400 Strumicë, tel. 322-182

INQK "Anton Panov" – Strumicë
UD Drejtor
Vanço Ristov

KOMUNA E GOSTIVARIT

ОПШТИНА ГОСТИВАР

GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-53/7

27.08.2018

Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M Ë R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridik se për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) për formimin e parcelave ndërtuese PN 1 dhe PN 2 në PK nr. 887 KK Zdunjë me dedikim A1 -Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e:

PREZANTIMIT PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) për formimin e parcelave ndërtuese PN 1 dhe PN 2 në PK nr. 887 KK Zdunjë me dedikim A1 - Komuna e Gostivarit që kufizohet ndërmjet rrugëve:

- Nga ana veriore me rrugën ekzistuese
- Nga ana lindore me rrugën për f. Debresh dhe zonën industriale
- Nga ana jugore me rrugën ekzistuese
- Në anën perëndimore me rrugën ekzistuese

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit, respektivisht në sallën e Këshillit të Komunës së Gostivarit më datë **05.09.2018 (e mërkurë) në ora 13:00**

Projekti Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) për formimin e parcelave ndërtuese PN 1 dhe PN 2 në PK nr. 887 KK Zdunjë me dedikim A1 - Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit dhe do të zgjasë 5 ditë pune prej **05.09.2018 deri 11.09.2018, prej orës 08:00 deri 16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, ndërsa në afatin e paraparë personat e interesuar juridikë dhe fizikë mund t'i parashtrojnë vërejtjet me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

KOMUNA E GOSTIVARIT

ОПШТИНА ГОСТИВАР

GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-315/16

30.08.2018

Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M Ë R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) për parcelën ndërtuese G.19.237 të PDU në bllokun 19 për KK Gostivar 1 me dedikim G2 - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e:

PREZANTIMIT TË PËRSËRITUR PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Për Projektin Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) për parcelën ndërtuese G.19.237 të PDU në bllokun 19 për KK Gostivar 1 me dedikim G2 - Komuna e Gostivarit, me përfshirje projekti prej **67702,7 m2** që kufizohet me:

- Nga ana veriore me rrugën nr."3", "4" dhe parcelat ndërtuese
- Nga ana jugore me G. 19.238; G. 19.239; G. 19.241
- Nga ana lindore me rrugën e parashikuar të re nr. "4"
- Nga ana perëndimore me rrugën "1"

Prezantimi i përsëritur publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit, respektivisht në sallën e Këshillit të Komunës së Gostivarit më datë **06.09.2018 (e enjte) në ora 13:00.**

Projekti Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) për parcelën ndërtuese G. 19.237 të PDU në bllokun 19 për KK Gostivar -1 me dedikim G2 - Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit dhe do të zgjasë 5 ditë pune prej **06.09.2018 deri 12.09.2018, prej orës 08:00 deri 16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, ndërsa në afatin e paraparë personat e interesuar juridikë dhe fizikë mund t'i parashtrojnë vërejtjet me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

10 GOLA KUQEZI, BESART IBRAIMI

Behrami
tregon pse iu
besua shiriti
i kapitenit

Valon Behrami beson se është emëruar kapiten i Udineses për shkak se flet shumë gjuhë të huaja dhe vepron si lehtësues. Kosovari i Zvicrës ka thënë se e konsideron përgjegjësi shtesë ta bartë shiritin e kapitenit. "Shiritin e kapitenit të Udineses e konsideroj përgjegjësi shtesë. Unë flas shumë gjuhë, prandaj përpiqem të jem lehtësues në dhomën e zhveshjes, duke u ndihmuar njerëzve ta kuptojnë njëri-tjetrin", tha Behrami. Ai theksoi se kjo është pikërisht arsyeja pse drejtuesit e klubit ia kanë besuar shiritin e kapitenit. "Mendoj se kjo është arsyeja pse ata vendosën të ma jepnin rolin e kapitenit", shtoi ai.

NDJENJË E PAPËRSHKRUESHME

Ibraimi vlerësoi paraqitjen e skuadrës kundër Shkupit, duke theksuar u arkëtuan tri pikë në një transfertë të vështirë. "Kundër Shkupit e pamë të gjithë se ishte ndeshje e vështirë, por ne e menaxhuam mirë takimin për të marrë tri pikë të mëdha dhe shpresoj të vazhdojmë me këtë ritëm"

100 gola me Shkëndijën e Tetovës në të gjitha kompeticionet. Kjo shifër i përket Besart Ibrahimit, realizoi dy herë në transfertë me Shkupin, duke i dhënë skuadrës së tij fitoren 2-1 në Çair. Kështu numri 7 shkon arrin këtë shifër në ndeshjet zyrtare me Shkëndijën, prej të cilëve 71 në Ligën e Parë të futbollit të Maqedonisë, 15-të në Kupën e Maqedonisë dhe 14-të në Kupat e Europës (5 në Champions League dhe 9 në UEFA Europa League). "Është ndjenjë e pazëvendësueshme të shënosh 100 gola me fanellën kuqezi. Është një ndejnë që se përshkruaj me fjalë dhe me këtë rast dua të falënderoj gjithë bashkëlojtarët dhe trajnerët me të cilët kam bashkëpunuar drejt ar-

ritjes së kësaj shifre, tifozët, "Ballistët" në veçanti dhe të gjithë ata që më kanë ndihmuar të vij deri këtu", – u shpreh plot entuziazëm Besart Ibrahimit, pas ndeshjes me Shkupin, duke shtuar se ky rekord e motivon të japë edhe më shumë në të ardhmen. "Unë gjithmonë

them se kam dhënë dhe do të vazhdoj të jap më të mirën për këtë fanellë, me shpresë për shumë gola tjerë që do të ndihmonin skuadrën dhe do të gëzonin tifozët kudo që janë".

Ibraimi vlerësoi paraqitjen e skuadrës kundër Shkupit, duke

theksuar u arkëtuan tri pikë në një transfertë të vështirë. "Kundër Shkupit e pamë të gjithë se ishte ndeshje e vështirë, por ne e menaxhuam mirë takimin për të marrë tri pikë të mëdha dhe shpresoj të vazhdojmë me këtë ritëm".

OSMANI: FITORE E RËNDËSISHME PAS LODHJES NË EUROPE

Trajneri i kuqezinjve, Qatip Osmani vlerëson se Shkëndija meritoi fitoren kundër Shkupit pasditen e të dielës në Çair. Kuqezinjtë arkivuan fitoren e dytë radhazi pas katër javëve në Ligën e Parë të futbollit të Maqedonisë, ndërsa stafi teknik vlerëson reagimin e ekipit pas lodhjes dhe eliminimit nga Europa. "Për ne ishte me shumë rëndësi ta fitonim këtë ndeshje, sepse ndihet lodhja nga ndeshjet europiane. Megjithatë, mendoj se kjo ishte fitore e merituar. Pas

ndeshjes me Rosenborgun në play off të UEFA Europa League kishim bregë nëse do të shkojnë gjërat si duhet. Loja e sotme tregoi se ekipi ka lënë pas atë që ndodhi në Europë dhe tani jemi përqendruar në kampionatin e Maqedonisë". Më tej Qatip Osmani komentoi 100 golat e Besart Ibrahimit në ndeshjet zyrtare me Shkëndijën. "Më gëzon që Besarti shkon në shifërën e 100 golave dhe mendoj se nuk do të ndalet këtu. Bëhet fjalë për futbollist shumë cilësor".

Valon Berisha, mungesa e madhe e Kosovës

Valon Berisha është vlerësuar prej lojtarëve më të rëndësishëm të Kosovës në eliminoret për botërorin e futbollit "Rusia 2018". Mesfushori i Lazios vazhdon të vlerësohet i rëndësishëm për "dardanët", ndonëse ka kohë që nuk është paraqitur për përfaqësuese. 25-vjeçari do të mungojë edhe në dy takimet e para të Kosovës në kuadër të Ligës së Kombeve të UEFA-s, që luhen pas pak ditësh. Lideri i mesfushës së Kosovës nuk ka mundur të sanojë plotësisht një lëndim muskolor, që e pësoi para një muaji. Dhe për këtë arsye nuk po luan te Lazio dhe nuk është përfshirë në li-



stën e Kosovës për ndeshjet me Azerbajxhanin (7 shtator) dhe Ishujt Faroe (10 shtator). Berisha ka thënë se është i mërzhitur që do t'i mungojë Kosovës në dy

ndeshjet e para në garën e re të UEFA-s. "Ka një muaj që jam i lënduar. Kam tentuar të kthehem për ndeshjet e Kosovës, por nuk ia dola. Kurrë më i mërzhitur nuk

kam qenë që i mungoj Kosovës. Por tani e rëndësishme është shërimi im dhe nuk dua të humbasnjë ndeshje tjetër të përfaqësueses", ka thënë Berisha.

Challandes
publikon listën
e të ftuarve për
dy sfidat e
Kosovës

Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Bernard Challandes, e ka bërë publike emëroren e futbollistëve të cilët i ka ftuar për dy ndeshjet e Ligës së Kombeve kundër Azerbajxhanit, më 7 shtator në Baku dhe kundër Ishujve Faroe, më 10 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Grumbullimi i futbollistëve do të nisë të hënën, më 3 shtator, derisa dy stërvitje do të mbahen në Kosovë para udhëtimit në Baku.

KOSOVA
Emërimi i futbollistëve për ndeshjet kundër Azerbajxhanit dhe Ishujve Faroe në Ligën e Kombeve

Portierë:
1. Demir Gjani - Cyber Rapid
2. Fatim Mujdri - FK Kukësi
3. Visar Beqaj - FC Prishtina

Mesfushorë:
4. Arif Ibrahimović - GNK Dinamo Zagreb
5. Fidan Altun - KS Shkëndija
6. Mergim Myshiri - Royal Excel Mouscron
7. Arditon Ismajli - NK Hajduk Split
8. Kastriot Dermaku - Cosmos Calcio
9. Lart Paparado - SV Znojmo
10. Benjamin Kallaku - FC Zurich
11. Jettmir Krasniqi - FC Lugano
12. Alban Ramadani - FC Neuchâtel Xamax
Mesfushorë/ Sulmues:
13. Mekuran Rymizi - FC Zurich
14. Ferizolli Shaba - FK Start
15. Edin Voca - FC Luzern
16. Bernard Berisha - Albatros
17. Arber Zeneli - SC Heerenveen
18. Alton Berisha - SV Werder Bremen
19. Edon Zhegova - R.S.C. Genk
20. Berat Çelina - Swansea City
21. Elhan Rahmani - Odde BK
22. Donik Avdiçaj - FC Willem II
23. Vedat Muriqi - Cyber Rapid
24. Alton Berisha - Sheffield Wednesday

www.fbk-kosova.com

Përfaqësuesitë e Kosovës

LEGJENDA E ZVICRËS SHPËRTHEN NDAJ SHQIPTARËVE

XHAKA NUK DUHET TË JETË KAPITEN, BEHRAMI PATI PUSHTET TË TEPËRT

Ish-mbrojtësi i njohur zviceran, Stéphane Henchoz, thotë se trajneri ka dështuar të mbajë skuadrën e bashkuar. Ai ka kritikuar edhe Behramin. "Mendoj se trajneri i ka dhënë shumë pushtet, dhe është ditur se një ditë do të ndodhë kjo. Trajneri e ka pyetur veten? Kush ka më shumë pushtet? Unë apo ai?". Ish-kapiteni i Zvicrës nuk ka lënë pa kritikuar edhe Shaqirin, duke thënë se ka shpërdoruar rastin sa ishte te Bayerni

Festa me shqiponjë nga Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri nuk është harruar ende në Zvicër. Përkundër se u dënua nga FIFA dhe u ngritën shumë debate, kjo çështje, nuk ka përfunduar. Së fundi për ekipin e Zvicrës ka folur ish-lojtari i saj, Stéphane Henchoz. Ai në një intervistë për 'Blick', ka thënë se helvetikët luajtën dobët në Rusi, sidomos ndaj Suedisë, derisa ka kritikuar veprimin nga Xhaka dhe Shaqiri, përcjell albinfo.ch.

"Stephan Lichtsteiner me gjasë nuk do të



jetë në formacionin e parë, por kush duhet të bartë shiritin e kapitenit. Yann Sommer ose Granit Xhaka, por unë preferoj Sommer. Xhaka luan rregullisht në Arsenal, por kapiteni i Zvicrës duhet të jetë zviceran. Jam kundër që Xhaka të bëhet kapiten. Xhaka nuk e përfaqëson as Zvicrën dhe as zviceranët. Ai nuk këndonte as himnin e Kombëtares. Do ta godisja shuplakë, kur nuk e këndon himnin kombëtar", thotë ish-futbollisti i Liverpoolit, transmeton albinfo.ch. "Nëse Petkoviç vendos që Xhaka të bëhet kapiten, atëherë do të ishte një problem. Futbollistë si Sommer, Schaar apo Li-

chtsteiner që kanë përfaqësuar Zvicrën tradicionalisht, do të ndiheshin të lënë jashtë. Edhe vetë tifozët, nuk do ta shihnin më Zvicrën si ekipi që i përfaqëson", ka shtuar tutje ai. "Disa lojtarë thonë se kanë dëshirë të madhe të luajnë për Zvicrën. Pse, sepse sigurojnë një kontratë të mirë pas Botërorit? Nuk dua që ata të këndojnë himnin si amerikanë-jugorët apo italianët, por të paktën ta ndiejnë atë? As Petkoviç nuk e këndon, edhe ai nuk është model për t'u marrë".

Ish-mbrojtësi i njohur zviceran thotë se trajneri ka dështuar të mbajë skuadrën e bashkuar. Ai ka kritikuar edhe Behramin. "Mendoj se trajneri i ka dhënë shumë pushtet, dhe është ditur se një ditë do të ndodhë kjo. Trajneri e ka pyetur veten? Kush ka më shumë pushtet? Unë apo ai?". Ish-kapiteni i Zvicrës nuk ka lënë pa kritikuar edhe Shaqirin, duke thënë se ka shpërdoruar rastin sa ishte te Bayerni.

"Ai nuk e kuptoi se çka kërkohet nga ai. E bëri stërvitjen, shkoi në Zvicër e vizitoi miqtë e tij. Ndoshta ka ngrënë edhe ndonjë qebab. Pastaj u kthye në Muni për dy orë e gjysmë. Nëse vozit me veturë për dy orë e gjysmë, kjo nuk është e mirë për muskujt e këmbëve. Lëndimet e muskujve nuk ishin fat i keq. Ju jeni i pafat kur ju një kundërshtar ju lëndon, por duhet të kujdeseni për trupin tuaj". Stéphane Henchoz ka luajtur në Xamax, Hamburger, Blackburn, Liverpool, Celtic, Wigan, Blackburn. Gjithashtu luajti 72 ndeshjen për Zvicrën.



Rashica i gatshëm t'i japë "krah" Kosovës

Rashica ishte shumë i disponuar të dielën mbrëma. Kishte arsye të fortë për këtë. Ai një ditë para grumbullimit me përfaqësuesen e Kosovës, të shtunën, shënoi gol të bukur në çastet e fundit për t'ia siguruar Werder Bremenit fitoren 2:1 ndaj Eintracht Frankfurtit në kuadër të xhiros së dytë të Bundesligës së Gjermanisë. 22-vjeçari realizoi nga një goditje dënimi. Ylli i Kosovës në ndeshjen në Frankfurt u aktivizua në minutën e 83-të, derisa golin e tri pikëve e shënoi në minutën e 96-të. Kështu Rashica vetëm ka vazhduar me paraqitje të mira në fillim të edicionit. Në xhiron e parë kishte asistuar në barazimin 1:1 me Hannoverin. Falë fillimit të mirë, sidomos falë golit të së shtunës, ai është maksimalisht i motivuar që edhe me Kosovën të shkëlqejë. Madje shpreson të shënojë ndonjë gol. Rashica të dielën mbrëma është vendosur në kampin e përfaqësueses së Kosovës. Përfaqësuesja të hënën (sot) nis përgatitjet për dy ndeshjet e para në kuadër të Ligës së Kombeve. Kosova më 7 shtator luan në udhëtim ndaj Azerbajxhanit, ndërsa më 10 shtator e pret përfaqësuesen e Ishujve Faroe në Prishtinë...

Publicitet

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2, nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015-teksti i pastruar) dhe nenit 142 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013), UD Drejtori i IPKÇF "Estreja Ovalija - Mara" Manastir publikon

SHPALLJE PUBLIKE nr. 5/2018 Për punësim për kohë të pacaktuar

1. Edukator për fëmijët e moshës prej 2-6 vjeç - një (1) person për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme

-Profesor i diplomuar i lartë/sipëror për edukim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijët të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor - me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar të shkallës VII/1 ose me arsim të lartë të mbaruar përkatës për edukatorë

- pa përvojë pune

- licencë valide për edukatorë

Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat ndahen në 30 orë për punë të drejtpërdrejtë me fëmijë, dhe koha e mbetur për aktivitete të tjera, prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i kohës së punës caktohet në mënyrë të shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:00.

Neto pagesa bazë është 19.581 denarë për përgatitje sipërore profesionale ose 18.514 për përgatitje të lartë profesionale.

2. Enëlarës -1 (një) person për kohë të pacaktuar

Kushtet e posaçme të nevojshme

-Arsim fillor

- pa përvojë pune

Orari i punës është 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 8:30 deri në ora 16:30.

Neto pagesa bazë është 12.161 denarë

Krahas kushteve të posaçme të theksuara kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme ligjore.

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Diplomë (Certifikatë), Dëftesë për arsimin e mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuar);

- Licencë valide (për edukator)

- Certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj);

- Certifikatë të lindjes (jo më të vjetër se gjashtë muaj);

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën do dënohet për veprë penale dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Shpallja zgjatë tre (3) ditë pune nga dita e publikimit të saj.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej dyzetepesë (45) ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPKÇF "Estreja Ovalija - Mara" - Manastir, rr. "Naum Naumovski Borçe" pn, Manastir.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IPKÇF "Estreja Ovalija - Mara" Manastir

Drejtor

Lidija Tfirst Mitrevska

Publicitet

Drejtori i Institutit të Letërsisë Maqedonase - Shkup, shpall

KONKURS për zgjedhjen në të gjitha gradat shkencore

- Në sektorin për Letërsinë popullore maqedonase - 1 hulumtues shkencorë për të gjitha gradat shkencore
- Në sektorin për Letërsinë e lidhjeve letrare-historike maqedono-ballkanike - 1 hulumtues shkencorë për të gjitha gradat shkencore.

Kandidatët duhet të kenë doktorat nga shkencat humane dhe ti plotësojnë kushtet për zgjedhjen në gradat shkencore të parapara me Ligjin për veprimtari hulumtuese shkencore (gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë, nr. 46/08, 103/08, 24/11, 80/12, 24/13, 147/13, 41/14, 145/15, 154/15 30/16 dhe nr. 53/16), Rregullorja për mënyrën dhe procedimin për zgjedhjen në gradat më të larta shkencore (gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë nr. 82/09) dhe Rregullorja e Institutit të Letërsisë Maqedonase - Shkup, për kriteret dhe procedimin për zgjedhjen në gradat shkencore dhe në bashkëpunëtorë shkencorë.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin në katër kopje: fletëparaqitje me një biografi të shkurtër; vërtetim për kryerjen e shkallës përkatëse arsimore; formulari i plotësuar i aktiviteteve për zgjedhjen në gradën shkencore dhe listën e punimeve të selektuara shkencore.

Konkursi zgjat 8 ditë, nga dita e shpalljes.

Fletëparaqitjet të adresohen në adresën:

ISHP Instituti i Letërsisë Maqedonase
Shkup, Grigor Prlicev nr. 5; Fax 455

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" - Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

“Në Itali ka më shumë përqendrim në mbrojtje se në sulm dhe ai e di këtë gjë, pasi që ai është lojtar i mençur”, ka shtuar Allegri

Shterpësia e Cristiano Ronaldos në Serie A të Italisë po vazhdon edhe më tutje. Superylli portugez ka dështuar të gjejë golin me Juventusin edhe në ndeshjen e tij të tretë zyrtare. Ronaldo ndonëse luajti tërë ndeshjen ndaj Parmës të shtunën mërzitëse, nuk arriti të shënonte. Skuadra e tij triumfoi 2:1 në udhëtim, transmeton “Koha Ditore”. Ronaldo nuk kishte shënuar gol as në ndeshjet ndaj Chievos dhe Lazios, të cilat po ashtu Juve i fitoi. Ylli portugez gjatë ndeshjes ndaj Parmës mori edhe një goditje nga mbrojtësit kundërshtarë dhe shihej me sy të mavijosur.

“Ai është lojtar i madh dhe do të shënojë, pasi ai është shumë i rëndësishëm për këtë skuadër. Ish-te i pafat kësaj radhe, por ne do ta ndihmojmë atë dhe ka mjaft kohë. Ai ishte pak i mërzitur që nuk arriti të shënonte, por do të vijë gola”, ka thënë mesfushori francez i Juventusit, Blaise Matuidi, që realizoi golin e fitores për skuadrën torineze.

Po dje, trajneri i Juventus, Massimiliano Allegri ka komentuar formën e Ronaldos që nga ardhja e tij në Juventus dhe faktin që ai

ALLEGRI NUK PRET 40 GOLA NGA RONALDO



ende nuk ka shënuar gol. Këtë gjë ai e sheh si normale duke mos pritur nga portugezi të shënojë gola sa ka shënuar në Spanjë. “Në Itali është më e vështirë të shënohen 40 gola”, është shprehur italiani.

Ai tregoi dallimin e futbollit italian me ligat e tjera. “Në Itali ka

më shumë përqendrim në mbrojtje se në sulm dhe ai e di këtë gjë, pasi që ai është lojtar i mençur”, ka shtuar Allegri. 51 vjeçari u shpreh se është i kënaqur me performancën e lojtarit më të mirë në botë në fitoren ndaj Parmas. Trajneri i Juventusit, është shprehur

se nuk shqetësohet për këtë shterpësi të Ronaldos, që erdhi në Itali si golashënues rekordmen i Real Madridit. Ai u transferua nga skuadra madriline për 117 milionë euro. Ronaldo nuk ka shënuar gol në tre ndeshjet e para të Zonjës së Vjetër në Serie A.



“CORRIERE DELLO SPORT” ia ndryshon numrin Ronaldos, e bën CR5.5

Cristiano Ronaldo ende nuk ka shënuar gol me Juventusin në Serie A. Sulmuesi i ardhur nga Real Madridi luajti takimet e para të sezonit të ri por nuk ka qenë i saktë para portës kundërshtarë. “Corriere dello Sport” në numrin e sotëm ka publikuar një titull: CR 5,5, duke i ndryshuar numrin Ronaldos në formë të vlerësimit për paraqitjet e tij të deritashme në Torino. Juventus ka fituar tri ndeshjet e para të sezonit dhe kryeson Serie A me 9 pikë të grumbulluara.

Klopp vërtetë i lumtur me Alisson

Portieri Alisson Becker, bëri gabimin e tij të parë në fanellën e Liverpool-it, megjithatë menaxheri ishte i kënaqur me performancën e tij.

Gjatë ndeshjes me Leicester City, Alisson ka pranuar golin e tij të parë të sezonit të Premier Ligës gjatë fitores tyre 2-1 kundër ekipit Leicester City. Por trajneri i Liverpool-it, Jurgen Klopp, është shprehur “me të vërtetë i lumtur” me performancën e tij. Alis-

son 25 vjeçar, iu bashkua klubit në korrik pas një marrëveshje të raportuar prej 66.8 milion dollarësh, shkruan Goal. Klopp ka hedhur poshtë çdo sugjerim se portieri ishte arrogant, duke shtuar se ai ishte në rregull me gabimin që kishte ndodhur.

“Ai është 0.0 për qind arrogant dhe ai është i bindur se mund ta bëjë këtë”, ka thënë trajneri Klopp për gazetaret.



Pellegrini nuk shkarkohet

West Ham nuk ka fituar ende në katër ndeshjet e Premierligës. Trajneri Manuel Pellegrini nuk është në rrezik për t'u shkarkuar nga skuadra londineze edhe pse nuk ka arritur të shënojë fitore në këto katër ndeshje të fillimit të stinorit. Pellegrini i ka bërë disa transferime gjatë verës, mirëpo ende nuk ka sjellë fitore, me humbjen e fundit që e pësoi nga Wolverhamptoni. Skuadra e tij është brohoritur nga tifozët pas humbjes, edhe pse në Tetor e pret një kalendar i vështirë, mirëpo drejtuesit e klubit nuk e kanë ndërmend që ta shkarkojnë Pellegrinin.

Suso në bisedime me Milanin për kontratën e tij

Suso dhe Milani i kanë hapur diskutimet mes tyre për një marrëveshje të re, shkruan Calciomercato. Agjenti i spanjollit, Alessandro Lucci dhe drejtori teknik i Milanit, Leonardo, i kanë filluar bisedimet para se të mbyllej afati kalimtar i transferimeve. Ende janë disa de-

taje për t'u përpunuar pasi që Suso i kërkohet të punojë në fushë dhe të punojë me disa nga lojtarë e ri. Për Susos gjatë kësaj vere janë interesuar disa skuadra si Roma e Napoli, mirëpo sulmuesi anësor ka vendosur që të mbetet në San Siro.



Zaniolo bën histori në Itali

Mesfushori i Romës, Nicolo Zaniolo, është bërë vetëm futbollisti i katërt në histori që është ftuar të përfaqësojë A e Italisë pa debutuar në Serie A. Zaniolo ka mbushur 19 vjet në korrik dhe është lojtar i dal nga akademia e Interit. Ai ka kaluar te Roma këtë verë si pjesë e marrëveshjes që dërgoi Radja Nainggolanin te Interi. Mesfushori kreativ është befas në listën e lojtarëve që ka publikuar seleksionuesi i Italisë, Roberto Mancini, për ndeshjet e Ligës së Kombeve kundër Polonisë e Portugalisë. Zaniolo ka luajtur 18 ndeshje për Italinë në grupmoshën U-19, duke realizuar gjashtë gola, por ende nuk ka debutuar në Serie A. Tre lojtarët e tjerë që janë ftuar në përfaqësues pa debutuar në Serie A ishin Raffaele Costantino në vitin

1929, Massimo Maccarone në vitin 2002 dhe Marco Verratti në vitin 2012. Mirëpo Maccarone kishte kaluar te përfaqësuesja A nga ajo U-21, ndërsa Zaniolo ende nuk ka luajtur as për përfaqësuesen U-21 të Italisë.





Hazardi shijon stilin e Sarrit

Eden Hazardi e ka konfirmuar që ai po e shijon kohën e tij në manaxhimin e Maurizio Sarrit dhe se dallon shumë nga Antonio Conte. Chelsea i Contes është kritikuar për lojën e tij jo të mirë, por londinezët dhe Hazardi janë shumë të lumtur me trajnerin e ri, dhe katër fitoret e para të stinorit të ri në Premierligë. "Sigurisht, më pëlqen që ta mbaj topin", ka thënë belgu për Chelsea TV. "Më pëlqen ky lloj i lojës. Është komplet ndryshe nga Antonio Conte dhe Jose Mourinho. E kemi më shumë topin dhe kjo nuk është keq për mua. Mendoj se diferenca e madhe është transferimi i Jorginhos dhe Kovacicit. Kur e kemi kontrollin e topit më shumë, ne mund të rrezikojmë më shumë". Hazardi ishte afër largimit nga Londra gjatë kësaj vere për t'u transferuar në Real Madrid, mirëpo ai vendosi që të qëndrojë në "Stamford Bridge" së paku deri në fund të kontratës së tij.



Vajza e artë nga Japonia

Notarja japoneze Rikako Ikee është bërë sportistja e parë që është shpallur më e vlefshme (MVP) në Lojërat e Azisë, që janë mbyllur të dielën. Tinejxherja fitoi plot gjashtë medalje të arta individuale në pishinë, në ngjarjen e madhe shumë-sportëshe të mbajtur në Jakarta të Indonezisë, shkruan Reuters. Vetëm qitësi nga Koreja e Veriut, So Gimman, që fitoi shtatë të arta e një të argjendtë në New Delhi në vitin 1982, ka qenë më i suksesshëm në një edicion të Lojërave të Azisë. Notarja 18-vjeçare ka fituar edhe dy të argjendta në stafetë duke arritur në shifrën e tetë medaljeve gjithsej në Lojërat e Azisë të këtij viti. Të gjitha gjashtë medaljet e arta ajo i fitoi me kohë rekorde për Lojërat e Azisë dhe arritja e saj është më e jashtëzakonshme pasi erdhi në Jakarta menjëherë pas kampionatit Pan-Pacific, ku fitoi një të artë, dy të argjendta dhe një të bronzë. Ikee, numri i medaljeve të arta të së cilës është më i madhi i fituar nga një sportiste në një edicion të Lojërave të Azisë, ishte zgjedhje unanime për epitelin e sportistes më të vlefshme në Lojërat e Azisë, ka njoftuar të dielën Këshilli Olimpik i Azisë.

Themelet e Manchester City janë të paprekshme, thotë Sheikh Mansour bin Zayed Al Nahyan. Pronari i klubit anglez dëshiron që ta bëjë Cityn klubin më të mirë të botë. Tashmë ka kaluar një dekadë që prejse Mansour mori pronësinë e klubit nga "Etihad"



NJË DEKADË ME SHEIKËT

Ishte pothuajse e paevitueshme që shkëlqesia e tij, Sheikh Mansour bin Zayed Al Nahyan, një ditë do të bëhej pronar i një klubi nga Premierliga. "Unë gjithmonë e kam shijuar biznesin, ndiej dashuri për lojën dhe më pëlqen të garoj", thotë ai. Por, pse City? "Investimi në një klub ishte një gjë që do të bëhej me patjetër", shton ai.

"Themelet e Cityt janë të paprekshme. Ata ishin testuar me rënien e ekipit në divizion më të ulët dhe ishin dukshëm të fortë. City ishte gjithçka që unë po kërkoja. Ishte një gjigand i fjetur", shprehet Mansour. Gjatë dekadës së fundit Sheikh Mansour dhe kryetari Khaldoon Al Mubarak kanë bashkëpunuar ngushtë për progresin e klubit. "Ai dhe unë flasim për Cityn pothuajse në baza ditore. Jo, në fakt çdo ditë. Mendoj se ne e kemi idealin e të kuptuarit dhe të

ritmit të punës. Më lejon mua të jem i përfshirë aq shumë ose aq pak sa më lejon agjenda ime", thotë ai.

Edhe pse ai ka marrë pjesë vetëm në një ndeshje në "Etihad", Sheikh Mansour gjen një mënyrë që t'i shikojë të gjitha ndeshjet e Cityt. "Më pëlqen që t'i shikoj ndeshjet. Kjo është gjëja më e rëndësishme. Në fund të ditës, jam një tifoz dhe i ndiej ndeshjet në të njëjtën mënyrë si çdo tifoz tjetër. I ndjek ndeshjet kudo që jam në botë", shprehet Mansour. Për Sheikh Mansourin fitorja në gjysmëfinalen e FA Cup ndaj Manchester Unitedit në prill të 2011-ës ishte një moment i madh. "Aty ishte momenti kur e kuptova që kishim arritur në një nivel të ri, në vendin ku donim të ishim. Ekipi ishte fantastik në paraqitjen e asaj dite. Nuk mendoj që ndjeva emo-

cione, sepse thjesht ekipi ishte duke luajtur me mentalitetin e duhur", thotë ai.

Sheikh Mansour ishte po aq i emocionuar si çdokush tjetër kur City e fitoi Premierligën për herë të parë një vit më vonë. "Ndeshja kundër QPR-së për mua ishte njësoj si për çdokënd tjetër. Nuk mendoj se do të shohim diçka të tillë përsëri. Shpresa ime është që të garojmë për Premierligën çdo vit, kështu që ishte një ndjenjë që e dija se duhet të mësoheshim shpejt me të", shprehet Mansour.

Ajo që nuk është e qartë ende është se kur do të përfundojë projekti. Ai nuk është duke treguar shenja të humbjes së interesimit. "Rrugëtimi me Cityn ishte që gjithmonë të tentonim ta kompletonim punën tonë në një mënyrë që të arrinim një standard i cili ende nuk ka arritur në futboll", shpj-

gjon ai. "Për ta bërë këtë ne duhej të kujdeseshim për gjithçka dhe të siguroheshim që çdo pjesë e organizatës të shkonte drejt një standardi të ri për futbollin. Ne ende nuk jemi aty, por kemi bërë një rrugë të gjatë dhe mendoj që njerëzit që më njohin mirë mua do t'u tregojnë se nëse do të jemi afër arritjes së qëllimit ne do të vendosim standarde të reja dhe synime për t'u arritur", thotë ai. Edhe pse ai mund të duket si një njeri i vështirë për t'u kënaqur në biznes, Sheikh Mansour si tifoz i futbollit duket shumë i kënaqur me futbollin që po luhet te City një dekadë pasi ai e bleu klubin.

"I bukur, inteligjent dhe i pasionuar. Është lloji i evoluimit të lojës që shpresoja që do ta arrinim një ditë", u përgjigj ai pasi u pyet se si i duket loja e ekipit të tij nën drejtimin e Pep Guardiolas.

Nuk jemi në ritmin e Liverpoolit dhe të Chelseat

Pep Guardiola është i bindur se kampionët e Premier Ligës, Manchester City, do ta kenë sfidën e titullit me Liverpool dhe Chelsea

"Qytetarët" u kthyen në fitore falë golave të lojtarëve të Anglisë, Raheem Sterling dhe Kyle Walker, teksa panë një Newcastle United të ashpër në stadiumin "Etihad", shtatë ditë nga një barazim (1-1) zhgënjës në Wolves. Liverpool dhe Chelsea kanë marrë pikët e tyre 100 për qind përgjatë fillimit të këtij kampionati, ndërsa Watford çuditërisht e ka mposhtur Tottenhamin 2-1 të dielën, transmeton ksp. "Ne kemi të njëjtat pikë si në sezonin e kaluar, në këtë moment", tha ish-drejtuari i Barce-



lonës dhe Bayern Munichut. "Kundërshtarët tanë kanë më shumë pikë se atëherë. Chelsea kishte lënë pikë, edhe Liverpool disa. Ne e dinim kualitetin e tyre. Duam të fitojmë nivelin më të mirë, por jam aq i befasuar për atë që ka ndodhur në sezonin e kaluar", shtoi ai.

Sidoqoftë, Guardiola është i kënaqur me atë që ka parë deri tani, në katër ndeshje, ku ka ndryshuar

edhe formacionin. "Kur kthehesh nga Kampionati Botëror, nuk e di se si do të reagosh në aspektin e qëndrueshmërisë. Ne e mundëm Chelsean në 'Community Shield' dhe, në përgjithësi, në katër ndeshjet ishim më të mirë se skuadrat e tjera. Kjo është ajo që po kërkojmë: të jemi më mirë. Pastaj, ndonjëherë fitojmë, ndonjëherë jo", ka thënë Guardiola. "Të jesh më mirë është të kontrollosh, të krijo-

sh më shumë shanse dhe të pësoh më pak. Në të katër ndeshjet, madje edhe në 'Community Shield', kjo është ajo që ndodhi. Ne do të përmirësohemi. Është pothuajse e pamundur pas Kupës së Botës, pas asaj që ka ndodhur sezonin e kaluar, mendërisht për lojtarët dhe të gjithë, që të jenë në gjendje më të mirë. Ne kemi nevojë për më shumë kohë dhe, pas pushimit ndërkombëtar, sezoni fillon si duhet në aspektin e lojërave çdo tri ditë", shtoi ai.

"Ajo që duhet të bëjmë është që të përpiqemi të jemi më mirë se kundërshtari, në çdo lojë të vetme, të përpiqemi të ndjekim atë për të cilën kemi folur dhe jemi përgatitur. Kjo periudhë, në pesë ndeshjet zyrtare që kemi luajtur, ka ndodhur. Do të dëshironim të shënonim më shumë gola, por ne kemi krijuar shanse", përfundoi Guardiola.

DASHI 21. mars - 20. prill
Një ditë jo fort e mirë kjo për të lindurit e kësaj shenje pasi partneri/ja juaj do të jetë shumë i irrituar sot. Bëni sa të mundni për t'i qetësuar. Beqarët duhet të jenë të duruar nëse duan të gjejnë personin e përshtatshëm. Në planin financiar gjërat do shkojnë mirë sipas parashikimit të yjeve.

DEMI 21. prill - 21. maj
Shijojeni këtë ditë të hënë. Do të jetë e mbushur me komunikime të këndshme dhe të dobishme për ju që jeni në një marrëdhënie. Koha është e shenjtë për ju. Beqarët do e kalojnë jetën sentimentale në plan të dytë. Financat do jenë mjaft delikate.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Mundësi të reja do t'ju japin shansin të dilni nga "rutina" në të cilën jeni zhytur ju të dashuruarit. Mos prisni shumë prej të tjerëve, por organizohuni dhe relaksohuni. Beqarët do kenë një ditë të ndërlikuar dhe nuk do mendojnë për dashurinë. Buxheti nuk do jetë i kënaqshëm gjatë kësaj periudhe.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Një ditë e mirë për juve. Marrëdhënia me partnerin/en do të vazhdojë të bëhet gjithnjë e më e ngrohtë. Është një ditë e mirë për të përfunduar punët e lëna përgjysmë. Beqarët do jenë joshës, prandaj do arrijnë ta bëjnë për vete cilindo person që do pëlqejnë. Financat nuk do jenë mirë.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Do të ndiheni shumë të frymëzuar sot i cili do të vihet në plan të parë të ditës. Pavarësisht sesa shumë punë keni për të bërë, do të gjeni kohë edhe për partnerin/en. Beqarët do i japin prioritet absolut jetës sentimentale dhe do afrohen mjaft me një person fantastik. Në planin financiar fati do jetë në anën tuaj.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Një ditë me ulje dhe ngritje kjo e sotmja. Pavarësisht se do të prireni drejt vetmisë sot, nuk do të ndiheni shumë të rënë moralisht. Megjithatë sot është një ditë e mirë për ta kaluar me njeriun e zemrës. Beqarët do kenë ndryshime drastike të statusit dhe takime të veçanta. Financat do jenë në ditë të mirë.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Ju jeni mjaft dyshues por ju këshillojmë që t'i lini mënjandë dyshimet. Përfitoni nga dëshira juaj për të planifikuar gjithçka dhe kthejini gjërat lidhur me partnerin/en në avantazhin tuaj. Beqarët do realizojnë takime të veçanta, por nuk do ndihen gati për lidhje. Gjendja e financave do jetë e mirë.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Tregohuni të kujdesshëm dhe të vëmendshëm ndaj partnerit/es suaj sot. Mbani mend faktet interesante që t'i përdorni. Beqarët nuk duhet të kenë frikë të fillojnë një lidhje. Buxheti për fat të mirë do fillojë të stabilizohet.


SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Sot ndiheni shumë joshës dhe në humor të mirë. Personi i zemrës mund t'ju kushtojë vëmendje të veçantë dhe kjo do t'ju pëlqejë shumë. Beqarët do arrijnë të afrohen me personin që pëlqejnë dhe do ja shprehin ndjenjat. Në planin financiar gjërat do jenë të ekuilibruara.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Dashuria dhe martesja janë në mendjen tuaj prej disa kohësh për ju që jeni në një marrëdhënie. Kujdesuni që të nxirrni në pah virtetet tuaja. Beqarët do kenë mundësi të reja për të krijuar lidhje. Në planin financiar do dini si ti menaxhoni të ardhurat.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Një ditë mjaft e mirë. Po ndiheni shumë mirë, veçanërisht të shëndetshëm, energjik dhe tërheqës ju të dashuruarit. Partneri/ja do t'jua bëjë ditën shumë të këndshme. Beqarët duhet të tregohen më të duruar në mënyrë që të gjejnë personin më të mirë për ta. Kujdes financat.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Sot do të kaloni një ditë të mirë, sidomos në çift. Ngrohtësia juaj e natyrshme për partnerin/en do të jetë më se e dukshme gjatë kësaj të hënë. Shijojeni sa më shumë ditën. Beqarët duhet të jenë gati dhe të kujdesshëm pasi rrethohen nga persona mjaft interesante. Në planin financiar gjërat nuk duken edhe aq mirë por ju do të keni ndihmë.



KOHA	ZEMËR (ITAL) GRABITËS, VJEDHES	K	GUSTAVO ZAPATA	NËNA	NUËRI NGA THEMELUESIT E KOMPANISË NË FOTO (POSHTË MAJTAS)	MARR DËCKA QË MË DORËZOHET	PËRZIERJE POLITIKANI YNË, HAZBI	Mensur Mamuti	BANOR ISHBA-VE	BOSHTI IKRAHARORIT	NË ANTIBIOTIK INJUHUR
KOMPLEKSI I GUGLLIT (NË FOTO)								PËRMËR VETOR			
AKTORJA AMERIKANE, KULLUNI								ËRNOVELISTI ANGLEZ, SOMERSET TRIM			
FLORI			MAŠIV MALOR NË BURMË "AKRONIM"					H			
BRITISH EUROPEAN AIRWAYS				KRYENEÇËSI ARGJENDI				KANCER AKTORJA AMERIKANE, UEST			
SHKRONJË KARAKTERISTIKE E JONIA		ISH FUTBOLLISTI FRANCEZ, OLIVIE SPANUA									
NUËRI NGA THEMELUESIT E KOMPANISË NË FOTO (POSHTË DJATHTAS)											NUMËR NËSHIFROR TEK
								JODI			
								OKSIGJENI QYTET NË SLOVENI			
								SHOSHTI NOTË MUZIKORE			
								ARMEND REXHEPAGIJI GRAMI			
								MOTORI MË I MADH I KERKIMIT NË BOTE, I THEMELUAR MË 04 SHTATOR 1989 (ORIGJ.)			

ZGJIDHJET: ATA, MOM, HERO, RAK, K, MIKS, GUGËLLI, PLEKSI, ROZMARI, AIK, AR, ARAKAN, LL, BEA, INAT, GJA, E, KAPO, ALEV, SERGEJ, BRIN, J, O, SIT, XHIND, AR, GOOGLE.

shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

1	7		9			6		3		2		
	7		1	4	2	3		1			8	
			9		4	7	9		6	3	1	
8								9	2			
2	4	3		9	6	8	2	5	8	1		
7					1			4	1			
2	7			5			2	8		9	4	3
		3	9	6	4		6		8			2
	1			7	3			7		2		5


Shumë i lehtë: 412735968, 697814253, 538692147, 385146729, 124379685, 769528314, 276453891, 853961472, 941287536. Mesatar: 168934527, 342175968, 795286431, 514392786, 927568314, 836417295, 281759643, 659843172, 473621859.

NGJANTE ME KRIMINELIN, VUAJTI 17 VITE BURG PADREJTËSISHT

Një person i pafajshëm ka vuajtur 17 vite burg për një krim që nuk e kishte bërë, por kishte një ngjashmëri identike me kriminelin, autor të ngjarjes. Richard Jones, nga Kansas City u burgos pasi kishte një ngjashmëri shumë të madhe me kriminelin, dhe për pasojë e pësoi shumë keq. Pasi ka kryer dënimin, ai po kërkon 1 milionë paund kompensim për 17 vitet e humbura brenda qelisë. Jones u lirua nga burgu vitin e kaluar pasi një gjyqtar vuri në pikëpyetje dënimin dhe identitetin e tij. Ai u burgos për grabitje me armë në vitin 1999 pasi një dëshmitar okular e identifikoi. Megjithatë, ndërsa ishte në burg, të burgosurit e tjerë në mënyrë të përsëritur i thanë atij se dukej si një kriminel i quajtur Ricky Amos. Jones jetonte në anën tjetër të Kansasit, ndërsa kriminelin që ngjasonte me të jetonte afër vendit ku ndodhi grabitja. Më vonë doli se nuk kishte prova të ADN-së apo gjurmëve të gishtërinjve që lidhnin Jones me kriminelin.



Tani ai ka paraqitur një padi duke kërkuar 1 milion dollarë kompensim nga shteti i Kansas. Babai i dy fëmijë, i cili ka humbur periudhën e rritjes së vajzave të tij 24 vjeç dhe 19 vjeç, po kërkon edhe ndihmë financiare për shkollim, strehim dhe këshillim.



I kemi nëpër duar, njihuni me celularët që lëshojnë më shumë rrezatim

Telefonat smartphone, janë tashmë pjesë e përditshme e jetës sonë. Por kur i blejmë cilat janë karakteristikat që mbajmë në konsideratë për të zgjedhur telefonin më të përshtatshëm për ne? Janë shumë të paktë përdoruesit që kontrollojnë sasinë e rrezatimit të aparatit, por edhe se sa energji konsumon. Por kush janë celularët që lëshojnë më shumë rrezatim? Në vend të parë është modeli Xiaomi Mi A1, i ndjekur OnePlus 5T, Huawei Mate 9, Huawei P9 Plus, Huawei GX8, Huawei P9, Huawei Nova Plus, OnePlus 5, Huawei P9 Lite. Më pas vjen iPhone 7, Sony Xperia XZ1 Compact, OnePlus 6, iPhone 8, Xiaomi Redmi Note 5 e ZTE Axon 7 Mini. Ndërsa më pak rrezatim lëshon Samsung Galaxy Note.

Izraeli e shpall të jashtëligjshme kërcimin në prehër

Vallëzimi në prehër së shpejti mund të bëhet vepër penale në Izrael, pasi udhëzimet e reja nga zyra e avokatit të shtetit i bënë thirrje policisë të godasë klubet e natës që kultivojnë praktikën. Ndërkohë që prostitucioni është ligjor në Izrael, format e saj të organizuara siç janë shtëpitë publike nuk janë. Strip-klubet e vallëzimit po shtohet në atë listë. Një direktivë e re nga avokati shtetëror i Izraelit synon pronarët e klubeve që lejojnë praktikën, e konsideruar si industri sek-

si. Një deklaratë nga zëvendës-avokati i shtetit, siç përmendet nga Jerusalem Post, përshkruan vallëzimin në prehër si "veprimtari që në rrethana të caktuara përbën prostitucion. Si e tillë ... do të konsiderohet vepër penale kundër së cilës mund të ndërmerren masa të gjera". Policia ka filluar të zbatojë udhëzimet e reja me zell, duke paralajmëruar pronarët e strip-klubeve të mërkurën se nëse ata kapen, do të mund të përballen me masa administrative.



A janë fëmijët 100% të mbrojtur nëse vaksinohen?

Vaksinimi është një ndër procedurat standarde më të rëndësishme në mjekësi tek fëmijët që nis me lindjen dhe vazhdon deri në adoleshencë. Libri i vaksinimit ka të përcaktuar qartë dozat që merren dhe moshën. Edhe pse shpeshherë ngrihen pikëpyetje mbi efektet anësore në ndonjë rast, ato janë konsideruar nga shkencëtarët si përfundime të pabazuara. Por një



pyetje që shpesh herë prindërit i bëjnë vetes është se nëse fëmijët e tyre janë 100% të mbrojtur nëse vaksinohen?

Përgjigja është "JO". Ai që është mjaft i rëndësishëm dhe rrit së tepërmi sigurinë është "imuniteti i turmës". Kjo do të thotë që të gjithë fëmijët të jenë të vaksinuar, shkruan "New York Times". Ndaj në çerdhe dhe kopshte fëmijët nuk pranohen nëse nuk vërtetohet se janë vaksinuar. Një komunitet me imunitet më të ulët, shihet si rrezik për më të vegjlit.

1024 - Konrad II Lundruesi shpallet Mbret i Gjermanisë.

1609 - Lundruesi Henry Hudson zbulon ishullin Manhattan.

1866 - Botohet gazeta e parë ditore në Havai.

1885 - Hapen kafeneja e parë (NYC).

1914 - Britania, Franca dhe Rusia nënshkruajnë Paktin e Londrës kundër Gjermanisë.

1918 - Trupat amerikane zbarkojnë në Arkangjel, qëndrojnë 10 muaj.

1919 - Mustafa Kemal Atatürk, i cili themeloi Republikën e Turqisë, mbledhi një kongres në Sivash për të vendosur për të ardhmen e Anadollit dhe Trakisë.

1930 - Hapet Teatri i Kembrixhit në Londër.

1939 - Holanda dhe Belgjika shpallin neutralitetin.

1970 - Balerina ruse Natalia Makarova merr azil politik.

1994 - Bije qeveria e Berovit në Bullgari.



Në disa kultura njerëzit me sy blu konsiderohen si një lloj mallkimi, ndërsa në të tjera shihen si tipar bukurie. Ekspertët, kanë zbuluar disa fakte interesante që tregojnë se personat që kanë sy blu janë më të veçantë nga të tjerët, të cilët janë me ngjyrë më të errët. Sipas një studimi të kryer nga Universiteti i Pitsburgut, gratë me sy ngjyrë blu e përballojnë dhimbjen më shumë se ato me sytë e errët. Femrat me sy blu e kanë më të lehtë lindjen e një fëmije, se të tjerat me sy të errët. Gjithashtu, studimi tregoi se fëmijët me sy blu ishin më të turpshëm dhe kureshtarë. Ata ishin më të dyshimtë për gjërat e reja.

FOTO PËR PASAPORTË

Polici hapte një gropë, ndërsa një kalimtar rasti e pyet: - Pse po e hapë këtë gropë.

Polici: Do të bëj një foto për pasaportë.

Kur kthehet kalimtari, e sheh prapë policin duke hapur gropën tjetër, i thotë: E tash ç'po të duhet kjo gropë.

Polici: Mi kanë kërkuar dy foto.



Tregohu i mirë me ata që mësojnë, mund të përfundosh duke punuar për ta. (Bill Gates)



KALENDARI HISTORIK 4 SHTATOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS